



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.05.2015, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin nga llogaria EU/IPA e by-pass-it Vlorë, për by-pass-in e Vlorës”.
3. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”.
4. Shqyrtimi i raportit vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2014.
5. Raporti vjetor i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduart Halimi, Arben Ristani, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Tom Doshi, Silva Caka, Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Mimoza Loli – përgjegjëse e Sektorit të Huamarrjes në Drejtorinë e Drejtimit të Borxhit Publik në Ministrinë e Financave

Elona Mistrovica – specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme e Shërbimeve Financiare në Ministrinë e Financave.

Ylli Manjani – zëvendësministër në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Ermal Nuri – specialist në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Ketrin Treska – drejtore në Drejtorinë e Oponencës Ligjore, Ministria e Drejtësisë:

Igli Totozani - Avokati i Popullit

Ermir Kapedani – komisioner, Avokati i Popullit

Arben Shkambi – komisioner, Avokati i Popullit

Etilda Gjonaj Saliu – komisionere, Avokati i Popullit

Erind Pirani – ndihmëskomisioner, Avokati i Popullit

Alket Jaupi – ndihmëskomisioner, Avokati i Popullit

Mimoza Morina – ndihmëskomisionere, Avokati i Popullit

Armand Nexha - shoqërues i komisionerit Ermir Kapedani, Avokati i Popullit

Jorida Rustemi - drejtore e Mekanizmit Kundër Torturës, Avokati i Popullit

Irma Baraku – komisionere, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ardiana Hala – këshilltare, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Meqë kuorumi është realizuar, fillojmë mbledhjen e komisionit.

Në pikën e parë të rendit të ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin nga llogaria EU/IPA e by-pass-it Vlorë, për by-pass-in e Vlorës”.

Pikë e dytë e rendit të ditës është projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”

Pikë e tretë është shqyrtimi i raportit vjetor për veprimtarinë e Avokatin e Popullit.

Pika e katërt është “Raporti vjetor i komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2014”.

Fillojmë me projektligjin e parë. Nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës është i pranishëm zoti Ylli Manjani, zëvendësministër.

Nga Ministria e Financave është zonja Mimoza Loli, përgjegjëse e Sektorit të Huamarrjes, në Drejtorinë e Borxhit Publik.

Mirë se erdhët!

Zoti Manjani, besoj se do të na bëni një paraqitje të shkurtër të projektit.

Zoti Manjani.

Ylli Manjani – Faleminderit!

Projekti është një sipërmarrje goxha voluminoze.

Nga ky parlament dhe komisioni, janë kaluar deri tani marrëveshja e BERZH-it me 18 milionë euro kredi, marrëveshja me BEI-n, 18 milionë kredi. Ky është komponenti i tretë i financimit tërësor të kësaj rruge, që është me 17 milionë euro grant nga fondet IPA të vitit 2012. Është paraqitur në parlament edhe ky komponent i tretë, për të mbyllur ciklin e financimit, pavarësisht se baza legale ishte e mjaftueshme edhe për të kaluar në qeveri, por u soll në parlament për shkak të praktikës së mirë, edhe në respekt të detyrimeve kushtetuese që parlamenti të ketë gjithë njohjen e nevojshme për sa i takon pjesës së financimit të kësaj rruge, rreth 53 milionë gjithsej.

Komponenti i tretë është rëndësishëm, sepse zbut shumë efektet e kredisë. Ky aks është gjykuar si një aks i rëndësishëm i infrastrukturës në jug të vendit. Ideja është që të ndërtohet një baipas në Vlorë, aty ku mbaron sot autostrada Levan-Vlorë. Për sa i takon realizimit të volumeve

të punës është një punë goxha voluminoze, për shkak të karakteristikave teknike dhe gjeometrike të projektit. Flasi për një rrugë me gjerësi që varion 10,5-12,5 m. Kjo e dyta në pjesën e sheshtë të saj. Janë parashikuar të ndërtohen 27 mure betonarme, me lartësi maksimale 8 m dhe gjatësi totale 1600 m. Sipërfaqja totale është 4700 metër katror. Janë 22 mure të armuar me lartësi maksimale 18 m, gjatësi totale 2000 m dhe me sipërfaqe totale 14 mikë metër katror. Janë parashikuar në projekt 6 ura kryesore, me gjatësi 50-150 m. Gërmime dhe volume pune, edhe në shkëmb, janë diku të 1 milion e 300 mijë metër kub gërmime. Mbushje trasesh 700 metër kub.

Pak a shumë, kjo është pjesa teknike.

Për sa i takon projektligjit konkret, ai sugjeron ratifikimin e një marrëveshjeje granti. Nga pikëpamja ligjore dhe kushtetuese nuk shohim ndonjë problem. Marrëveshja është standarde. Vjen si rezultat i përdorimit të fondeve IPA, me të cilat shteti shqiptar ka vite që punon.

Siç thashë, u soll në parlament për shkak të praktikës së mirë, edhe në respekt të detyrimeve kushtetuese, por edhe për efekt transparence për të krijuar një praktikë të mirë parlamentare.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Nuk e besoj se ka diçka Ministria e Financave.

Zoti Fino, me cilësinë e relatorit.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Zëvendësministri e sqaroi saktë, drejt edhe nga pikëpamja teknike, ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Është për një objekt shumë të rëndësishëm dhe duhet ta votojmë patjetër. E vetmja rezervë që kam është se grantet nuk kanë pse të kalojnë në parlament, pasi janë kredit i ministrave. Kur është çështje kredie, është çështje tjetër. Grantet duhet të kalojnë më shpejt. Mos harroni që procedurat parlamentare sjellin vonesa, sa kalojnë në komisione, seancë plenare, sa zbardhen, ndërkohë që me një firmë ministri dhe vendim qeverie, ato mund të ishin bërë efektive më shpejt.

Ju lutem shumë, mos më vini relator kur ka çështje grantesh, pasi e kam thënë në grup dhe në parlament, që ato nuk duhet të kalojnë nga ne, që do të thotë se duhet t'i miratojnë ministrat dhe qeveria.

Them se nuk kemi pse ta vonojmë më shumë një grant të tillë prej 17 milionë eurosh.

Faleminderit!

Bashkim Fino – Faleminderit!

A ka pyetje? Nuk ka. Kush është dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë votimin në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në relacion të pasqyrohet edhe sugjerimi i relatorit për seancën plenare.

Zoti Manjani.

Ylli Manjani – Kjo është një nga ato marrëveshje granti për të cilat shteti shqiptar ka një marrëveshje kuadër me agjencinë donatore. Në parlament ato vijnë kur nuk ka marrëveshje kuadër dhe kërkon alokimin e fondeve për kostot lokale. Ka raste kur grantet vijnë në parlament, por ky nuk është rasti.

Fatmir Xhafaj – Mirë. Paraqesim sugjerimin dhe seanca plenare ta gjykojë.

E mbyllim këtu.

Faleminderit, zoti Manjani! Faleminderit, zonja Loli!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.05.2015, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduart Halimi, Arben Ristani, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Tom Doshi, Silva Caka, Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Ketrin Treska – drejtore në Drejtorinë e Oponencës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë:

Fatmir Xhafaj - Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 2215, “Për dhënie amnistie”.

Kush do ta paraqesë?

Zoti Ndoka.

Nard Ndoka – Faleminderit, zoti kryetar!

Është një nismë deputetësh për një ndërhyrje në ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, i cili ka përjashtuar nga vuajtja e mëtejshme e dënimit me një kategori të caktuar veprash penale, përjashtim sipas kriterëve që sanksionon ligji. Ky ligj ka përjashtuar nga ndjekja penale të personave që kanë kryer një kategori të caktuar veprash penale. Në këtë kuadër amnistie janë të përjashtuar nga dënimi të dënuarit për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi i parë i Kodit Penal. Gjithashtu, amnistohen nga ndjekja penale personat që e kanë kryer këtë vepër penale. Nuk amnistohen nga dënimi ose ndjekja penale personat që kanë kryer vepra penale të parashikuar nga neni 199, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Dallimi që bën ligji nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, për sa i përket ndërtimit të paligjshëm bie në kontradiktë me trajtimin uniform, jo selektiv, që i bëhet kësaj çështje te ligji nr. 9482, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar”. Në një formë të thjeshtuar mund të thuhet se penalisht e amnistojmë këtë ndërtim vetëm kur është bërë në tokën e personit që ka bërë ndërtimin e paligjshëm. Nuk e amnistojmë në rastet e tjera.

Dallimi që bën ligji midis paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 199/a të Kodit Penal nuk merr në konsideratë realitetin aktual. Sipas të dhënave që disponohen nga ALUIZNI vetë, rreth 30% e ndërtimeve të paligjshme janë bërë në pronë të vetë subjektit që ka bërë ndërtimin, pjesa tjetër, rreth 79%, janë bërë në tokë të tjetrit ose në tokë publike. Statistikat tregojnë se procedimet penale si dhe dënimet penale, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi i dytë, i Kodit Penal, numërohen me dhjetëra. Më i vogël është ky numër në rastin e kryerjes së veprave penale të ndërtimit të paligjshëm nga paragrafi i parë.

Në kushtet kur vetë shteti ka vendosur të legalizojë informalitetin dhe paligjshmërinë sipas disa kriterëve, nuk do të ishte me sens që të penalizoheshin personat që e kanë kryer këtë vepër penale në afatin që ligji u njeh të drejtën e legalizimit të ndërtimit të paligjshëm. Nga ana tjetër, faktikë procedimet janë vetëm disa dhjetëra, ndërkohë që fenomeni është masiv, të bën të mendosh se këto procedime ose kanë qenë selektive, ose organi procedues nuk ka kapacitete për

të ushtruar ndjekjen penale. Në të dyja rastet kemi një shkelje të parimit kushtetues, të të qenit të gjithë të barabartë para ligjit.

Për të rregulluar këtë, është paraqitur ky projektligj. Duke kërkuar mbështetjen tuaj me votë, riparojmë një defekt një problem shqetësues për qindra familje shqiptare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Dashi.

Kozma Dashi – E para, faleminderit për ftesën!

Pse kjo kërkesë amnistie? Problemi filloi me ligjin e INUK-ut. Të gjithë shqiptarët kishin një ndjeshmëri maksimale, pasi ishin para faktit për të amnistuar dhe për të rregulluar çfarë ishte bërë keq. Që në herën e parë, që në mbledhjen e parë me ministren Gjermani, datë 21.4.2014, kam ngritur vazhdimisht shqetësimin: pse dy persona që kryejnë të njëjtën vepër penale nuk trajtohen një lloj ndaj amnistisë? I pashë rekordet dhe nuk gjeta përgjigje. Problemi u bë shumë shqetësues. Pse? Praktikisht, të prekurit, që mbeteshin, gati 100 mijë, ishin në zonat rurale.

Nuk është puna se pse nuk iu dha përgjigje Kozma Dashit, sepse ai ishte më i gjerë. Problemi ishte te ato 100 mijë vetë që i mbajmë peng: janë të ekspozuar para ligjit dhe në çdo çast mund t'u priset shtëpia.

Unë do të ndjehesha shumë mirë po ta mbështesnim këtë nen, duke u dhënë mundësi këtyre njerëzve, që po ikin andej-këndej, që të hynin në procesin e legalizimit. T'u japim mundësi që çatinë mbi krye ta legalizojnë, kundrejt ligjeve. Mos të kemi histori të tjera. Unë shpresoj në mirëkuptimin tuaj që kjo kërkesë të kalojë, sepse është thelbësore për jetën e shqiptarëve. T'u lehtësojmë sadopak barrën e problemeve.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje?

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

I ndoqa të dy propozuesit e nismës, por më duket sikur ka një mospërputhje midis qëllimit, që tha kolegu Dashi, dhe nismës së sjellë këtu.

Pse e adresoni ndryshimin në Kod Penal dhe jo të ligji “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin”? Këto 100 mijë familje nuk janë të ndjekje penale. Kolegu Ndoka tha që ka një numër të pakët personash të hetuar dhe të gjykuar. Pse është ky shqetësimi në pjesën penale? Nuk zgjidhet me pjesën penale.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Keni një përgjigje?

Kozma Dashi – Kryesorja është të zgjidhet ky problem. Këta njerëz janë të ekspozuar para ligjit, sepse kanë kryer një vepër penale.

Fatmir Xhafaj – Zoti Ndoka.

Nard Ndoka – Një plotësim. Të jemi të qartë: ligji për legalizimit u jep të drejtë të drejtën e legalizimit këtyre familjeve. Këtu nuk ka nevojë për ndërhyrje. Me gjithë këtë të drejtë nga ligji, Kodi Penal i dënon. Kjo është përplasja ligjore që kërkojmë të rregullojmë.

Së dyti, me të vërtetë janë disa dhjetëra raste nga prokuroria, që ne mendojmë se janë selektive, por janë qindra raste të tjera që duhet të kishin një gjykim të barabartë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Majko.

Pandeli Majko – Me qëllim që ky propozim për amnisti të mos kthehet në një histori se kush është i miri dhe se kush është i keqi, çfarë po ndodh me shqiptarët dhe se çfarë do të bëjmë për ta, unë propozoj proceduralisht që të thirret drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-it, zoti Artan Lame, të na japë një panoramë të qartë, lidhur me këtë fenomen. Është mirë të shikojmë grafinë e këtij fenomeni, çfarë do të bëjmë për t’i dalë përballë dhe a ka vend për amnisti.

Unë po flisja me kolegen dhe i thashë se në njësinë time kam shumë probleme me pagesat e faturat e energjisë elektrike. Nuk është vendi për ta diskutuar tani se si mund të bëhemi të mirë me gjëra që janë në kurrizin e shqiptarëve. Nëse duam të bëjmë një amnisti, ta bëjmë atë më të plotë, më të studiuar, duke bashkëpunuar edhe me Ministrinë e Drejtësisë në vazhdim, por ta fillojmë, e kam procedurale këtë me ALUIZNI-in.

T’i japim qytetarit atë që do: të gjejmë mënyrën se si do t’ia japim letrat e shtëpisë. Po jo duke i thënë të presë për letrat, sepse hë për hë po e shpëtojmë nga burgu.

Besoj se kolegët do të kenë mirëkuptimin e plotë për kërkesën time procedurale.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka tjetër?

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Nuk e kuptoj qartë qëllimin pse ndërmerret kjo nismë. Ju thoni që neni 199/a ka ndryshuar, ligji ka ndryshuar në dhjetor të vitit 2014, ndërkohë që kërkoni të amnistohen ndërtimet jo më vonë se data 10 prill e vitit 2014. Pse keni vendosur dy data të ndryshme? Me çfarë e lidhni datën 10 prill 2014?

Nard Ndoka – Deri në atë datë janë të amnistuara dhe kodi futet në fuqi. Kemi pasur bashkëpunim edhe me ALUIZNI-n. Informacioni dhe statistikën janë marrë nga ai institucion. Shqetësimi është edhe i atij institucioni. Nuk bëhet kjo gjë për fushatë elektorale. Përkundrazi, është një lehtësim që u bëjmë familjeve shqiptare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka ndonjë statistikë për ata që janë proceduar?

Nard Ndoka – Sipas të dhënave që disponon vetë ALUIZNI...

Fatmir Xhafaj – ALUIZNI nuk ka procedimet penale.

Nard Ndoka – Sa është numri i procedimeve penale? Është disa dhjetëra, në një kohë që janë disa mijëra që mund të penalizohen, nëse ligji nuk do të ishte selektiv. Ky problem i krijuar mund të zgjidhet me ndërhyrjen që kemi propozuar. Ne jemi të prirë drejt asaj se prokuroria nuk ka pasur kapacitetet e nevojshme. Besoj se është një zgjidhje normale që ta bëjmë këtë riparim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Ajo që kuptoj nga diskutimi i kolegëve, apo pyetjet tuaja dhe të zonjës Hysi, si dhe sugjerimi i zotit Majko, është se jemi në një moment që duhet t'i mirëkuptojmë kolegët propozues, por nga ana tjetër do të isha dakord me procedurën që mbase i duhet kohë relatorit të bëjë konsultimet e nevojshme me të gjitha institucionet përkatëse, për të na sjellë ne si komision edhe një statistikë më të qartë, si dhe një rregullim të këtij projektligji. Ta bëjmë me qetësi, duke bashkëpunuar relatori me kolegët nismëtarë, që të mos kemi më as diskutime politike apo të tjera, por të sillen të gjithë njerëzit në raporte të drejta në funksion me ligjin dhe me ALUIZNI-n.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Manja.

Ulsi Manja – Jam dakord me qëndrimin e kolegëve për ta harmonizuar këtë nismë, por dua të sqaroj dy gjëra.

Përtej qëllimit të mirë të kolegëve propozues, nisma synon të garantojë dy parime kushtetuese: parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit. Jam dakord, siç tha kolegu Fino, ta konsultojmë këtë nismë, sepse si relator kam mendimin që afati 10 prill, që propozojnë kolegët, pasi të merret informacioni i duhur nga përfaqësuesit e qeverisë, të shtrihet përtej kësaj date, gjithmonë në funksion të harmonizimit të ligjit penal me ligjin për legalizimet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se tani jemi më të qartë për qëndrimin që duhet të mbajmë, por, për mua, nga pikëpamja e teknikës legjislative, ky formulim nuk është i saktë.

Së dyti, të krijon idenë e një zgjidhjeje pak selektive. Ky ligj nuk e zgjidh hallin e qindra dhe mijërave njerëzve, që kanë probleme me legalizimet. Ky ligj nuk është për masën, por për disa persona, që mund të kenë probleme me procedimin penal. Pse?

E para, zgjidhja e dhënë është e kufizuar.

E dyta, sa kohë që nuk zgjidh problemin themelor në ligjin e legalizimeve, nuk mund ta zgjidhësh me këtë ndërhyrje, pavarësisht se nga pikëpamja teknike duhet të ishte riformuluar ndryshe. Për këtë arsye sugjeroj, që në vlerësim të propozimeve të kolegëve, ta mbyllim këtu diskutimin dhe t'u kërkohej organeve përkatëse, qoftë atyre të zbatimit të ndjekjes penale, qoftë qeverisë dhe në mënyrë të veçantë ALUIZNI-t, të japin një informacion për trajtimin në gjerësi të këtij problemi. T'i kërkohej drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t të jetë prezent në një mbledhje komisioni dhe t'i kërkohej atij të parashtrojë të gjithë tablonë e plotë dhe të shohim si paraqitet ky problem, në raport me interesat e qytetarëve, të cilat ligji aktual për legalizimet nuk i ka trajtuar dhe nuk i ka zgjidhur. Besoj se kjo përbën interesin e ligjvënësve apo të përfaqësuesve të popullit, në mënyrë të veçantë të kolegëve, që janë përfaqësues të zonave ku legalizimi është një dukuri prezente.

Relatori së bashku me stafin të bëjnë praktikën e komunikimit me qeverinë, me Këshillin e Ministrave dhe me Prokurorinë e Përgjithshme dhe të caktohet një seancë, ku do të

ftohet zoti Lame dhe kolegët deputetë iniciues, të jenë të pranishëm, nëse dëshirojnë, në këtë seancë.

E mbyllim këtë pikë.

Falënderoj zotin Dashi dhe zotin Ndoka, për paraqitjen e këtij problemi!

Falënderoj dhe kolegët!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.05.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i raportit vjetor për Veprimtarinë e Avokatit të Popullit për Vitin 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduart Halimi, Arben Ristani, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Tom Doshi, Silva Caka, Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Igli Totozani	-	Avokat i Popullit
Ermir Kapedani	-	komisioner
Arben Shkëmbi	-	komisioner
Etilda Gjonaj Saliu	-	komisionere
Erind Pirani	-	ndihmëskomisioner
Alket Jaupi	-	ndihmëskomisioner
Mimoza Morina	-	ndihmëskomisionere
Armand Nexha	-	shoqërues i Ermir Kapedanit

Jorida Rustemi - drejtore e Mekanizmit Kundër Torturës

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, në shqyrtimin e raportit vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2014.

Zoti Totozani është i pranishëm.

Zoti Totozani, urdhëroni!

Raporti është vënë me kohë në dispozicion të kolegëve deputetë.

Kjo pikë ka qenë disa herë në rend të ditës, por për arsye objektive, të mirëkuptuara me zotin Totozani, stafet kanë vendosur shtyrjen në kohë të këtij raportimi. Raporti është i njohur për deputetët, sepse kanë pasur kohën e mjaftueshme për ta lexuar atë. Besoj se zoti Totozani do të bëjë një paraqitje të shkurtuar. Kemi pasur kohë gjatë gjithë këtij vitit ta kemi shpesh institucionin e Avokatit të Popullit në këtë tryezë. Për këtë arsye, besoj se mbetet për t'u thënë diçka e përmbledhur.

Zoti Totozani, keni ardhur së bashku me komisionerët.

Mirë se keni ardhur!

Fjala për ju.

Igli Totozani - Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë ju falënderoj për këtë seancë dëgjimore kushtuar raportit vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2014. Ky ka qenë një vit i ngjeshur me punë dhe me shumë aktivitet në të gjitha aspektet e punës së institucionit të Avokatit të Popullit, duke filluar nga parandalimi i shkeljes së të drejtave të njeriut, mbrojtjen e tyre, promovimin e tyre dhe një sërë aktiviteteve të tjera.

Sa u përket ankesave, të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë këtij viti ka pasur një numër të madh ankesash. Janë depozituar 3969 ankesa, kërkesa, apo njoftime.

Nga numri total i ankesave të depozituara gjatë vitit 2014, rreth 65% e tyre, apo 2572 ankesa janë konsideruar “brenda juridiksionit dhe kompetencës” së Avokatit të Popullit dhe 1397 ose 35% prej tyre janë konsideruar si “këshillime dhe orientime” për qytetarët. 793 ankesave u është dhënë përgjigje menjëherë, ndërsa 604 ankesave u është dhënë përgjigje në formë shkresore.

Duhet thënë që sikurse vitin e kaluar, në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, për punën e Avokatit të Popullit, edhe këtë vit ka funksionuar siç duhet reforma, që kemi

ndërmarrë në institucion dhe numri i ankesave jashtë juridiksionit dhe jashtë kompetencës është minimizuar deri në 10%, duke u dhënë mundësi punonjësve tanë të punojnë realisht për dosjet.

Duhet thënë që gjatë këtij viti janë mbyllur 1481 ankesa. 88 ankesa kanë qenë jashtë juridiksionit dhe 152 kanë qenë jashtë kompetencës së institucionit.

Kemi pasur 24 rekomandime të refuzuara, 209 rekomandime të pranuar, 437 ankesa të pranuar pa rekomandim dhe 44 ankesa nga të cilat është hequr dorë.

Ky ka qenë një vit i rëndësishëm për institucionin e Avokatit të Popullit, për faktin se pas një periudhe të gjatë kohe dhe një pune të madhe të kolegëve të mi dhe ndihmës së komisionit tuaj, institucioni ynë arriti të marrë statusin në Komunitetin Ndërkombëtar të Koordinimit të Institucioneve të Drejtave të Njeriut në OKB, gjë që ka qenë një nga arritjet më të rëndësishme të institucionit tonë në kuadër të OKB-së, gjë që na jep mundësi të shprehim opinionin në Këshillin e Drejtave të Njeriut në OKB, sa herë të jetë e nevojshme.

Gjithashtu, gjatë këtij viti titullari i institucionit është zgjedhur president i Shoqatës së Ombudsmenëve të Mesdheut. Institucioni është zgjedhur anëtar i Këshillit Administrativ të Organizatës së Ombudsmenëve dhe Mediatorëve Frankofonë, si dhe anëtar i Bordit Europian të Organizatës Botërore të Ombudsmenëve.

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka rritur numrin e situatave të ndjekura me iniciativë, pra, ka rritur rolin e tij proaktiv. Kemi rreth 192 raste të ndjekura me iniciativën e vetë institucionit, kryesisht me njoftime të marra nga shtypi, nga deputetë të ndryshëm, nga qytetarë dhe të njoftuara, në krahasim me vitin e kaluar.

Në kuadër të rolit proaktiv të Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2014, rezulton se, janë realizuar gjithsej 138 inspektime në këto institucione në mbarë vendin: (njësitë policore, paraburgime, burgje, spitale psikiatrike, qendra rezidenciale etj.).

Nga këto inspektime, në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve të Tjera Çnjerëzore e Poshtëruese (OPCAT), gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit ka kryer 115 inspektime, apo ri-inspektime të thelluara, në funksion të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Mjeti ligjor kryesor i Avokatit të Popullit është rekomandimi me qëllim vënien në vend të së drejtës së shkelur nga organi i administratës publike. Numri total i rekomandimeve drejtuar organeve të administratës publike gjatë vitit 2014 është 368, prej të cilave 24 janë refuzuar dhe

209 rekomandime janë pranuar plotësisht. Kemi një numër rekomandimesh pa përgjigje (rreth 61 të tilla).

Në bazë të problematikave të evidentuara nga rastet e trajtuara dhe analizave ligjore konkrete të zhvilluara nga institucioni, gjatë vitit 2014 janë përgatitur gjithsej 27 rekomandime legislative, për nxjerrje, për amendime, apo plotësime të ligjeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe i është drejtuar 2 herë Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu, Avokati i Popullit, ka përgatitur gjatë këtij viti 7 raporte të veçanta të dorëzuara në Kuvend, në lidhje me tematika të rëndësishme, siç është gjendja e spitaleve, për emigracionin, një raport i veçantë për gjendjen e kërkesave të azil-kërkuesve shqiptarë në vendet perëndimore, i dorëzuar në gusht të vitit të kaluar dhe një numër raportesh të tjera, siç është raporti për të drejtën e informimit.

Avokati i Popullit, në ushtrim të funksionit të tij kushtetues, në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2014 shqyrtimin me vëmendje të veçantë të ankesave të ardhura nga individë që u përkasin grupeve të dobëta, qoftë individualisht, qoftë si organizata, të cilët janë edhe gupet më të rrezikuara sa i takon jetës në Shqipëri.

Kemi organizuar një sërë trajnimesh, në bashkëpunim me administratën lokale, në bashkëpunim me shoqatat e Shoqërisë Civile dhe në mos gaboj, ishin 402 punonjës të administratës lokale, të trajnuar nga Avokati i Popullit dhe një numër po kaq i madh i administratës së burgjeve, të sistemit të paraburgimit dhe të policisë.

Kaq, sa u përket disa të dhënave të shkurtra.

Tani po bëj një panoramë të shkurtër për të drejtat në vend, duke filluar me dhunën ndaj grave, si një problem që ka vazhduar të jetë.

Gjatë këtij viti nga shqyrtimi i ankesave, në disa raste ka rezultuar se punonjësit e policisë nuk kanë vepruar në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë. Punonjësit e policisë kanë mangësi të theksuara në formimin profesional të tyre, pasi ata nuk i njohin dhe për pasojë, nuk zbatojnë si duhet, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga dispozitat e të Kodit të Procedurës Penale, dhe ligji Nr. 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Në këtë situatë është emergjent konsolidimi i mëtejshëm i mekanizmave të referimit kundër dhunës në familje, e në këtë drejtim bashkëpunimi i munguar ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre vendore duhet të përmirësohet, si dhe duhet të ngrihen strukturat, aty ku

mungojnë, konkretisht, streha publike dhe shërbimet sociale përkatëse për viktimat e dhunës në familje.

Ndërkohë, edhe gjatë vitit 2014 është rritur numri të vendimeve për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuara nga gjykata. Shpejtësisë së gjykatës nuk i përgjigjen strukturat e përmbartimit, të cilat duket se e gjejnë vështirësi të madhe në terren për zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar ndryshimet në Kodin Penal, lidhur me figurën penale të ngacmimit seksual dhe moral në punë.

Një problematikë, ku duhet të ndalemi, është përmirësimi i asistencës ndaj viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, veçanërisht grave dhe fëmijëve. Vijimësia e përpjekjeve me synim të hetimit dhe luftës së rasteve të dhunës dhe sigurimit të hetimit dhe gjyqimit dhe gjithë atyre me forcën e ligjit përbën një nga sfidat e vendit tonë.

Një tjetër sfidë kanë qenë të drejtat e fëmijëve (prioritet i institucionit të Avokatit të Popullit). Nevojitet ngritja e mekanizmave eficiente për zbatimin e legjislacionit dhe strategjive ekzistuese për fuqizimin e shtrirjen e njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ne kemi bërë një numër të madh rekomandimesh, sidomos për qendrat rezidenciale për fëmijë, për masat që duhen marrë për përmirësimin e infrastrukturës, e cila mbetet e dobët në disa shkolla të arsimit publik, pa përjashtuar këtu mungesën e aksesit në arsim, të kategorisë së fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Mbeten shqetësuese format e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, sidomos të abuzimit të fëmijëve në rrugë, duke përbërë kështu një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve. Rastet e dhunës ndaj fëmijëve në familje janë një fenomen shqetësues, i cili vazhdon të jetë prezent.

Sa u përket problematikave të tjera që nakanë shqetësuar, besoj se është mirë t'i nxjerrim gjatë bisedës me deputetët, por kemi pasur problematika në lidhje me masat e mara për energjinë elektrike. Ato janë problematika jo të vogla, të cilat i ka trajtuar institucioni i Avokatit të Popullit.

Një temë e rëndësishme, e cila ka zënë vend edhe në raportet e veçanta të institucionit të Avokatit të Popullit, janë largimet nga puna në administratë. Ky është një problem, gjithashtu, shqetësues për ne.

Një çështje që na ka shqetësuar gjatë këtij viti është ndihma ekonomike. Një numër i madh familjesh janë larguar nga kjo ndihmë ekonomike, si pasojë e skemës së re pilot që po aktivizohet në 3 qytetet kryesore: në Tiranë, Durrës dhe në Elbasan.

Nëse do të dëshironi, do të ndalemi më thellë në këto problematika. Një sfidë e madhe që mbetet për institucionin e Avokatit të Popullit për të cilën do të kërkonim dhe ndihmën e Kuvendit, është përcaktimi i minimumit jetik në Shqipëri.

Sot Shqipëria mbetet një nga vendet e vetme në Europë, që nuk ka një minimum të caktuar jetik, që do të bënte të mundur që i gjithë sistemi i pagave në vend, i pensioneve, i ndihmës ekonomike apo i subvencioneve të tjera që jep shteti, të përcaktohej në mënyrën më të saktë dhe më të qartë të mundshme.

Mungesa e një minimumi të caktuar jetik sjell një sërë pasojash në efikasitetin e sistemit social shqiptar.

Një numër problematikash, të cilat kanë ardhur në zyrën tonë dhe i kemi ndjekur në mënyrë proaktive, janë ato të legalizimeve apo prishjet e ndërtimeve pa leje, problematika, të cilat jemi munduar t'i ndjekim në kohë dhe të japim rekomandimet tona, qoftë për INUV-et, qoftë për INUK-un, gjë që na ka shqetësuar.

Po kështu, një tjetër çështje që na ka shqetësuar në sistemin e privimit të lirisë, kemi thënë se gjatë këtij viti ka pasur një mbipopullim të madh të burgjeve, deri diku do ta quaja alarmant, për pasojat që sjell në respektimin e të drejtave të njeriut në këtë sistem. Edhe këtë vit vazhdojmë të mos kemi një institucion të posaçëm për trajtimin e personave me problem të gjendjes mendore, të cilët vazhdojnë të gjenden në burgje, gjë që është një shkelje flagrante e të drejtave të njeriut.

Do të donim të vlerësonim miratimin e ligjit për hapjen e dosjeve, si një tjetër element i rëndësishëm në trajtimin e të drejtave të grupeve të persekuatuara, si një akt vërtet i rëndësishëm, i ndërmarrë nga Kuvendi i Shqipërisë, gjë që ne e kemi vlerësuar. Inicuesit që në shkurt të vitit 2014 vepruan me rekomandimin tonë dhe jemi të kënaqur që rekomandimi i institucionit tonë gjeti përgjigje nëpërmjet miratimit të këtij ligji.

Mbetet sfidë hapja e këtyre dosjeve, zbatimi i këtij ligji dhe gjetja e eshtrave të personave, të cilët janë vrarë gjatë diktaturës.

Një tjetër çështje e rëndësishme që ka shqetësuar Avokatin e Popullit, gjatë këtij viti për të cilën është dorëzuar një raport i posaçëm në Kuvend, është edhe strehimi.

Për këtë kemi hartuar një raport, i cili ka dalë si rezultat i një studimi në 42 bashki, në lidhje me familjet që gëzojnë statusin e të pastrehëve dhe numrin total të kërkesave. Nga të dhënat që na rezultojnë, në ato 42 bashki që iu përgjigjën studimit tonë, rezulton se janë 17427 familje prej të cilëve vetëm 2490 familje kanë përfituar trajtim me një nga programet sociale.

Po kështu, në fokusin e punës sonë i është kushtuar vëmendje e veçantë respektimit të drejtave të minoritetit rom, i cili vazhdon të përballët me një sërë problemesh, që cenojnë liritë dhe të drejtat e themelore të anëtarëve të këtij minoriteti. Ky minoritet përfaqëson sot një grup vulnerabël dhe në risk, i cili e ka të pamundur të përfitojë faktikisht nga sistemi ynë social, pasi atyre u është siguruar vetëm barazi formale në ushtrimin e të drejtave, por jo barazia thelbësore në ushtrimin e të drejtave të tyre, duke përfshirë këtu: strehimin, regjistrimin në gjendjen civile (në rastet e zhvendosjes nga një vendbanim në një tjetër), përfitimin e ndihmës ekonomike, apo për arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe çdo përfitim tjetër, që sistemi ynë social ua siguron qytetarëve.

Gjendja e të drejtave të minoriteteve në vend, parë në këndvështrimin e të drejtave të afirmuara në Konventën Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, ka qenë objekt i përgatitjes së një raporti të veçantë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Nga gjetjet e këtij raporti është arritur në konkluzionet se, nevojitet përmirësimi dhe përgatitja e një ligji për minoritetet, ku të bëhet përkufizimi i tyre.

Në kuadër të luftës kundër diskriminimit është kërkuar, gjithashtu, të rritet gama e shkaqeve ligjore, të cilat mund të çojnë në diskriminim, përfshi këtu ndalimin e diskriminimit me bazë kombësinë, një qëllim të shpallur për të diskriminuar, nxitjen për diskriminim, dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit. Duhet nënshkruar, sipas Avokatin e Popullit, Karta Europiane e Gjuhëve Krahinore ose Minoritare, që ka për qëllim mbrojtjen ose nxitjen e gjuhëve krahinore të pakicave, si një aspekt i kërcënuar i trashëgimisë kulturore të Europës.

Sa i përket aftësisë së kufizuar, që është një grup vulnerabël, sipas nesh, vazhdojnë një numër problemesh. Gjatë vitit 2014 janë paraqitur 57 ankesa. Problemet kryesore që PAK hasin janë: mungesa e përshtatshmërisë së aksesit në ambiente publike dhe private. Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë akses në transportin urban dhe publik. Moszbatimi i dispozitave ligjore për rimbursimin e biletës së transportit urban dhe interurban, dhe cenimi i të të drejtës së përfaqësimit të organizatave të PAK, anëtarë të të cilave janë vetë persona me aftësi të kufizuara, moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Mbetet problem shqetësues aksesit i këtyre personave në drejtësi, në strukturat qeveritare në nivel qendror dhe lokal, në medie dhe në biznes.

Mungesa e aksesit në arsimin publik të fëmijëve të personave me aftësi të kufizuara.

Në miratimin e ligjit nr. 93 të vitit 2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, nuk u morën në konsideratë propozimet tona për cenimin e përfaqësimit të organizatave të PAK, konceptimin si ligj kuadër, që nuk parashikon ndërhyrje konkrete në legjislacionin ekzistues, për qëndrimin e financimit vetëm te një ministri. Për të pasur akses në drejtësi, personat me aftësi të kufizuara, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se duhet të bëhen ndryshime legjislative në Kodin e Procedurës Civile, në Kodin e Procedurës Administrative, dhe në atë Kodin e Procedurës Penale, si dhe në ligjin “Për noterinë”. Ne po punojmë në këtë drejtim dhe pothuajse i kemi gati rekomandimet përkatëse.

Sa u përket të drejtave të komunitetit LGBTI, vlerësojmë rezolutën e Kuvendit. Ky ka qenë një hap i jashtëzakonshëm dhe historik dhe për këtë do të vlerësoja punën e Nënkomisionit të Drejtave të Njeriut në këtë komision, të kryesuar nga zonja Hysi, e cila ka qenë së bashku me ne promotore dhe me organizatat e tjera, si Komisioneri Kundër Diskriminimit dhe organizatat e tjera të Shoqërisë Civile.

Ky hap duhet të vazhdojë të ndiqet me një numër hapash konkretë, siç janë miratimi i ndryshimeve në Kodin e Familjes apo në ligjin “Për identitetin gjinor”.

Zoti kryetar,

Këto ishin disa nga çështjet kryesore, që kanë shqetësuar qytetarët tanë gjatë vitit 2014. Mendoj se gjatë bisedës, mund t’i ezaurojmë më tej.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Totozani!

Zoti Klosi, keni fjalën në cilësinë e relatorit!

Blendi Klosi – Sa i përket pozicionit tim si relator, nuk kam shumë për të shtuar, pasi ato janë në raportin e Avokatit të Popullit dhe në paraqitjen që bëri vetë Avokati i Popullit, për sa i përket arritjeve apo realizimit të detyrave që ata kanë në bazë të ligjit funksional në bazë të të cilit, funksionon institucioni i tyre.

Do të doja të përmendja se më shumë se statistikat, është raporti me komisionin tonë, sa i përket dhënies së mendimit disa herë rresht nga Avokati i Popullit për projektligjet që kanë kaluar në këtë komision, duke zbatuar kështu një nga pikat e projekt-raportit të KE-së të vitit

2014, i cili për sa i përket këtij institucioni, thotë se është e nevojshme që Avokati i Popullit të informojë apo të këshillohet për projektligje të reformës, sidomos për ato që ndikojnë direkt në fushën e tij të kompetencës.

Do të doja të ritheksoja raportin që ka pasur institucioni i Avokatit të Popullit, që paraqitet edhe në këtë raport dhe që u shpreh nga vetë zoti Totozani këtu, gjatë prezantimit. Kjo ka të bëjë me raportin e këtij institucioni me problemet që kanë të bëjnë me mekanizmat kombëtare të parandalimit të torturës, për të cilat Avokati i Popullit ka zhvilluar një sërë aktivitete dhe një sërë inspektimesh, ndërkohë që në raport me atë që komisioni nëpërmjet Nënkomisionit të Drejtave të Njeriut ka hulumtuar në disa nga pikat, ku zhvillohet aktiviteti i parandalimit të veprimtarive kriminale.

Ka një raport, i cili duhet parë drejtpërdrejt nga Avokati i Popullit në raport me këto institucione.

Një moment, i cili duhet të vijë në vëmendje të komisionit, është se përsëri në zbatim të progres-raportit ka pasur një aktivitet shumë herë më të zhvilluar ndërmjet këtij komisioni dhe Avokatit të Popullit. Nga 7 raporte të pjesshme, që janë paraqitur në komision, gjatë vitit 2014 ne kemi studiuar më shumë se 4 prej tyre, duke sjellë një risi progresive shumë herë më të lartë sesa më përpara, në raport ndërmjet Kuvendit si program ligjvënës me Avokatit të Popullit si organ, i cili ka një raport të drejtpërdrejtë me qytetarët shqiptarë.

Për sa i përket raportit të asaj çfarë dëgjuam tani nga Avokati i Popullit, mendoj që ka konstatime të cilat duhen marrë në konsideratë, ashtu siç ka dhe konstatime të cilat do të duhen që të vlerësohen në një këndvështrim tjetër, t'i largohemi fushatës elektorale, t'i largohemi asaj që njerëzit janë sensitivë dhe dëgjojnë me vëmendje, në atë çfarë duhet të jetë puna e përditshme e këtij komisioni. Departamenti përkatës pranë parlamentit shqiptar ka paraqitur dhe një projektrezolutë që do t'i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë, në të cilën vlerësohet puna e Avokatit të Popullit dhe po ashtu ka rekomandime për vitin 2015. Kjo projektrezolutë është në përputhje me historinë e raportit ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe Avokatit të Popullit, por edhe asaj çfarë Avokati i Popullit duhet të bëjë më shumë për vitin 2015.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Klosi!

Tani kalojmë në pyetje. Kush ka pyetje nga deputetët?

Po, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti avokat, për raportin e detajuar dhe për marrjen parasysh të një sërë rekomandimeve, që ka lënë Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën për vitin 2014!

Unë kam dy pyetje, lidhur me përmirësimin e punës së Avokatit të Popullit në të gjithë territorin, pra jo vetëm në Tiranë. Me ndryshimet që ne bëmë në ligj u krijua mundësia, që të hapen 7 zyra rajonale, ndërkohë që nga raporti i Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit të Shqipërisë, po dhe ju vet në raport pasqyroni një shpërndarje jo të njëjtë të ankesave të qytetarëve. Sa kanë ndikuar këto 7 zyra të hapura në qendrat urbane? Cila është arsyeja që qytetarët pavarësisht se zyrat janë hapur, nuk kanë të njëjtën shpërndarje do të thosha, adresimi për shqetësimet e tyre, te zyra juaj.

Çështja e dytë, ka të bëjë me rekomandimet. Ne kemi theksuar në rezolutë që Avokati i Popullit duhet të monitorojë zbatimin e rekomandimeve dhe jo thjesht një përgjigje, të cilën mund ta japë institucioni, por sa efektive kanë qenë rekomandimet e tij dhe cilat masa janë marrë? Cilat janë shqetësimet tuaja lidhur me këto rekomandime? Ndër të tjera, ju në fjalën tuaj thatë që, lidhur me personat me aftësi të kufizuara, ne kemi bërë rekomandime për ndryshime dhe duhen bërë ndryshime në Kodin e Procedurës Civile Penale dhe Administrative. Ne sapo e kemi miratuar Kodin e Procedurës Administrative, i bërë me asistencën e SIGM-ës dhe një procesi shumë gjithëpërfshirës dhe tryezash, nuk ka gjetur rregullim ky propozimi juaj, apo ju nuk e keni paraqitur në grupin e punës që u mor me miratimin e Kodit të Ri të Procedurave Administrative?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj- Faleminderit, zonja Hysi.

Ju lutem të fokusohemi te pyetjet, pa shumë komente, meqenëse bëri një paraqitje, zoti Totozani. Bëri një vlerësim të punës relatori, zoti Klosi, keni dhe rezolutën përpara, do t'ju sugjeroja që të fokusoheni te pyetjet dhe jo më shumë se 2 pyetje çdo kolegë deputetë.

Zoti Totozani!

Igli Totozani - Ju falënderoj për pyetjet zonja Hysi!

Për sa i përket zyrave rajonale, janë 7 të tilla dhe me ligjin e ri në njëfarë mënyre ato u përfshinë, se nuk ishin të përfshira. Kjo ishte një gjë pozitive e arritur. E rëndësishme në këtë rast do të ishte mirë që të dihej, që prej disa kohësh, ndoshta prej 2 vjetësh gjatë periudhës së formulimit të buxhetit, ne kemi përsëritur në mënyrë të vazhdueshme, rritjen e numrit të punonjësve të Avokatit të Popullit. Natyrisht, jo me rroga të larta ndihmëskomisionarësh, por

njerëzish të cilët do të qëndronin në këto zyra rajonale për të mbledhur ankesat e qytetarëve, apo për të ushtruar një sërë aktiviteteve të tjera, që kanë lidhje me institucionin e Avokatit të Popullit: monitorime, komunikim të vazhdueshëm me institucionet lokale e tjera.

Për fat të keq, gjatë këtyre 3 vjetëve nuk është miratuar në buxhet kjo zgjidhje, megjithëse zyrat rajonale janë pajisur dhe janë të gatshme për të mirëpritur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme punonjës në të. Për këtë arsye zgjidhja që kemi gjetur ne, në këto kushte ka qenë bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe në zyrat tona rajonale paraqitet në mënyrë vullnetare, një herë në javë, një përfaqësues i shoqërisë civile të atij qyteti ku gjenden këto zyra, në një periudhë të caktuar kohore të vogël, ditën e premte rreth 4-5 orë qëndrojnë aty. Unë, edhe një herë do të kërkoja ndihmën e këtij komisioni në njëfarë mënyre, që në buxhetin e ri të arrihej kjo gjë, qoftë edhe me paga më të ulëta në nivel specialisti, për të pasur një prezencë të përhershme në zyrat tona rajonale.

Megjithatë mund t'ju them që, me gjithë këto kushte të vështira, sepse punojnë njerëz vullnetarë dhe ju e dini vullnetarizmi në Shqipëri ende nuk ka ardhur me plot kuptimin e tij, nuk është pjesë e kulturës sonë të brendshme, kanë ardhur rreth 250 ankesa, janë mbledhur nga këto zyra rajonale, pra ka një sukses në këtë drejtim, në kushtet në të cilat po operojmë. Por, gjithashtu, mund t'ju them që ka një arsye psikologjike, pavarësisht se njerëzit shkojnë në zyrat tona rajonale, ata shpesh vazhdojnë të preferojnë që të paraqiten pranë zyrave të institucionit për të kërkuar takim me Avokatin e Popullit apo me komisionerët e tij. Por unë po përsëris edhe një herë: kërkoj ndihmën e këtij komisioni, në mënyrë që t'i bëjnë më efektive këto zyra ka nevojë për njerëz që të punojnë aty për 8 orë në ditë, të cilët ne edhe i trajnojmë. Ata që punojnë sot në mënyrë vullnetare janë trajnuar nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe jo më larg për një periudhë 1- muajore do të jenë në një vizitë zyrtare në Suedi, pikërisht për t'u trajnuar në këtë fushë, por punojnë gjithmonë e thash, janë pjesëtarë të shoqërisë civile dhe punojnë me vullnetarizëm.

Për sa u përket shqetësimeve në lidhje në zbatimin e rekomandimeve, jemi të ndërgjegjshëm për atë shqetësim që ju keni ngritur si Kuvend, sepse ka qenë një shqetësim yni më përpara, të cilin e kam gjetur që në ditët e para kur kam mbërritur në institucionin e Avokatit të Popullit, ku termi i përdorur në punën tonë ishte rekomandim i pranuar dhe shqetësimi ynë ka qenë, nëse është i pranuar duhet verifikuar nëse është zbatuar, apo jo. Jemi duke punuar edhe me kolegët danezë, për të gjetur një sistem dhe mbështetje financiare, për të realizuar një sistem

monitorimi të vazhdueshëm të Avokatit të Popullit nga institucione jashtë Avokatit të Popullit, në mënyrë që ky monitorim të nxjerrë rezultate dhe dobësitë e mirëfillta të këtij institucioni, që të na japë mundësi pastaj për t'i ndrequr dhe për t'i korrigjuar ato.

E kemi bërë një provë vitin e parë të mandatit tonë duke zgjedhur 2 përfaqësues nga një organizatë e shoqërisë civile, për të bërë monitorimin e jashtëm të institucionit Avokatit të Popullit. Rezultatet ishin shumë të mira, megjithatë, për të rritur legjitimitetin e këtyre e rezultateve, është jetike që kjo të vijë nga një strukturë jashtë Avokatit të Popullit dhe që të mos ketë lidhje varësie apo ndërvare, çfarëdolloi qoftë me Avokatin e Popullit. Po punojmë për të ngritur një sistem i cili jo vetëm për sot, por të jetë vazhdimisht pjesë edhe buxhetit të Avokatit të Popullit, pra të parashikohet një ushtrim i tillë, monitorues ndaj vetë institucionit tonë.

Për sa u përket rekomandimeve, duhet thënë, që nuk jemi shumë të kënaqur me rekomandimet, me përgjigjet sidomos të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Në disa raste institucionet shtetërore lënë për të dëshiruar në bashkëpunimin me ne. Mund t'ju them, që vitin e kaluar në 2014-n kemi pasur 61 rekomandime pa përgjigje, këtë vit janë gjithsej rreth 55 ose 60 rekomandime, po flas për vitin 2015, për 20 prej të cilave nuk kemi ende përgjigje. Ka dhe raste të cilat ne i konsiderojmë pjesërisht pozitive, ku rekomandimet tona zbatohen, i shikojmë në media që zbatohen. Një rast i tillë për shembull, ishte ligji për dosjet, që ju duhet ta dini, që si fillim u rekomandua nga Avokati i Popullit, në shkurt të vitit 2014 dhe më pas ende pa u njoftuar ne, për fillimin e ecursë pozitive të këtij ligji, pra ne nuk ishim njoftuar, na ndodh që në media të shikojmë që rekomandimet tona zbatohen, pa na ardhur një përgjigje neve si institucion i Avokatit të Popullit. Kemi pasur një bashkëpunim të mirë me ministren Felaj, e cila ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme, me listë të gjitha rekomandimet pa përgjigje dhe ka një lëvizje deri diku pozitive të institucionit, ka një ndërgjegjësim më të madh për t'u dhënë përgjigje rekomandimeve të institucionit tonë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Totozani!

Zoti Fino, keni fjalën.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, Avokati i Popullit!

Për mua, ky është raporti më serioz, më me problematikë, më në rritje, me kërkesa gjithmonë në rritje edhe me shumë rekomandime që keni dhënë ju dhe kjo vjen edhe për shkak të eksperiencës nga raporti në raport.

Por, gjithsesi unë dua të bëj disa pyetje, për ta përmbushur raportin tuaj dhe për të qenë të gatshëm, në këto rekomandimet që bëjmë edhe ne, si rekomandime tuajat që bëni për institucionet, se dhe ne rekomandime bëjmë për projektrezolutën në parlament. Ju ta keni si udhërrëfyes për punën tuaj në vitin që vjen. Çfarë dua të them me këtë? Dua të them që pyetja e parë, se nuk e dëgjova nga raportimi, e kam lexuar materialin tuaj, sa ankesa ka pasur për gjyqësorin dhe për prokurorin, për sistemin e drejtësisë në tërësi dhe si i keni shkuar ju arsyeve deri në fund? Ky është një problem shumë i madh sot për njerëzit, me atë që shikojmë dhe dëgjojmë, mos harroni se ne jemi këtu si legjislativi, ne ju dëgjojmë, ju ndihmojmë, siç po thoni që kërkon ndihmë nga ne. Duam t'ju ndihmojmë fort edhe në bërjen e ligjeve, edhe të rekomandimeve, që të ecim të gjithë përpara, për të pasur një sistem drejtësie shumë të mirë, por edhe një prokurori shumë të mirë. Deri tani nuk kam dëgjuar asgjë, për ankesat që jam i bindur që ka plot nga qytetarët.

Një pyetje e dytë, që unë doja të dija nga ju është...

Fatmir Xhafaj - Më fal, zoti Fino, ta heq edhe unë pyetjen time bashkë me këtë, se unë këtu e kisha merakun. Mund të ndihmoj veten, të shtoj diçka. Më fal!

I bashkohem zotit Fino, duke shtuar edhe diçka: Cili ka qenë komunikimi juaj me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me prokurorinë, pritshmëria që keni ndaj tyre dhe reagimi që kanë pasur? Do të dëshiroja që të përmbledheshin në një pyetje, që të mos bëjmë tjetër. Më fal, zoti Fino!

Bashkim Fino- Kjo është kryesorja.

E dyta, zoti Avokat i Popullit, ju jeni edhe avokati ynë, se edhe ne popull jemi apo jo? Po, ne si legjislativ bëmë një reformë, për të cilën ju kemi marrë mendim edhe juve, keni ardhur, keni diskutuar, keni dhënë mendime pozitive, keni dhënë sugjerime, e kam fjalën për Reformën e Ndarjes Territoriale Administrative në Shqipëri. Dua të them që ajo reformë u bë, u miratua më 21 qershor, do të ketë zgjedhje lokale mbi bazën e kësaj reforme të re territoriale. Ju si e shikoni organizimin e punës suaj, si Avokat i Popullit në funksion të kësaj ndarje të re territoriale? Sepse kjo është një ndarje e re, për mendimin tim, historike që të gjitha institucionet e shtetit shqiptar

duhet të jenë në funksion të kësaj ndarje dhe kjo ka lidhje edhe me atë që tha zonja Hysi, të këtyre 7 zyrave që ju keni ngritur dhe që gjithmonë kërkonin nga ne mbështetje.

E treta, që kam dhe kjo është dhe më kryesorja. Unë e kuptoj vështirësinë e punës së Avokatit të Popullit, sepse në fund të fundit është si puna jonë që diskutojmë pafundësisht ligje, miratojmë ligje dhe pasi i kemi miratuar dhe i ka dekretuar Presidenti, ka mbaruar puna jonë. Po sa zbatohet ligji? Ky është një problem komplet tjetër, që edhe ne ndihemi ndonjëherë shumë keq, se ne kemi miratuar dhe kemi dhënë një drejtim të caktuar. Por, unë që do të thosha se ju na thatë këtu, me raste konkrete që mbi 65% të kërkesave ishin brenda juridiksionit tuaj, në 3699 kërkesa, nga të cilat jeni të kënaqur me rekomandimet që keni bërë. Pyetja ime është shumë e sinqertë dhe kur them e sinqertë duhet ta kuptoni në kompleks të fjalës sinqeritet. Kur ju u keni bërë rekomandime gjithë këtyre institucioneve përkatëse, për problematikën që keni hasur a keni ngelur i kënaqur në problematikën dhe në rekomandimet që keni bërë dhe a i keni shkuar deri në fund atij rekomandimi që ju keni bërë, pavarësisht edhe të një përgjigjeje pozitive, siç keni thënë ju këtu dhe i kam mbajtur shënim, në rastin konkret, kanë kthyer përgjigje pozitive. Ne nuk jemi këtu për të falënderuar as ministrat, as institucionet, ne jemi këtu për t'i kritikuar, që ata vërtet rekomandimet që ju bëni si Avokat i Popullit t'i zbatojnë. Pyetja ime e sinqertë është: rekomandimet që ju bëni a zbatohen? Se unë e kuptoj vështirësinë siç ju thashë, e lidha bashkë me veten time, t'i vërtet i bën rekomandimet, por nuk mbaron puna jote këtu te rekomandimi, në fund të fundit, vjen në raport dhe thua se unë i kam bërë 192 rekomandime, nga të cilat kaq për qind dhe aq për qind. Problemi është se vërtet zgjidhin disa probleme këto gjëra, apo nuk zgjidhin asgjë mbaruam me rekomandimet dhe kemi bërë punën tonë, si Avokat i Popullit. Ata që janë në ekzekutiv, që kanë të drejtë të marrin vendimmarrjen të kanë kthyer një përgjigje, që të kanë kënaqur ty për momentin, oreksin tënd dhe timin bashkë, në fakt, problematika qëndron aty, vazhdon po ai problem. Kjo është pyetja, shumë e sinqertë që vërtet, ne duam të dimë, se si institucion ua dhamë, dhe vërtet ne duam më pas të ndihmojmë dhe në kuadrin ligjor, apo me probleme të tjera, pse jo për të marrë në interpelancë, për të thirrur këtu në komisionin tonë qoftë dhe me nënkomisionet e të Drejtave të Njeriut, ministra të caktuar, instrumente apo drejtues të institucioneve të caktuar, të cilët duhet të mbajnë përgjegjësi për problematikën që ju ngrini. Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme, e cila do të më bëjë mua vërtet shumë krenar kur të miratojë projektrezolutën në parlament, në qoftë se ju do të ma jepni përgjigjen e saktë dhe ma jepni të sinqertë.

Kam dhe një pyetje të fundit, që ka të bëjë, le të themi, me rritjen e transparencës së institucionit tuaj, sepse dhe ju nuk jeni me imunitet dhe ju mund të kontrolloheni. Problemi që kam unë është ky. Nga informacionet që ne duhet të kemi si komision, lidhur me donacionet që ju merrni nga të tretët, nga institucionet e huaja, nga të gjitha të tjerat, nuk na keni dhënë ndonjëherë ndonjë informacion ne si komision këtui, por në fakt në funksion të ligjit që mban duhet t'i sillni informacionin e shkruar Komisionit të Ekonomisë për donacione të tilla. Në kuadrin e kësaj transparence dua të di si janë raportet e këtyre donacioneve që merrni ju dhe i keni transparente qoftë me Komisionin e Ekonomisë, qoftë me ne, qoftë me publikun, sepse duke qenë ju vetë shumë i qetë dhe transparent, keni të drejtë pastaj t'ia kërkonit dhe institucione të tjera? Nuk e di do të kemi diskutime apo jo, kryetar, për këtë çështje, sepse kam dhe shumë mendime, shpjegime të tjera për të diskutuar në lidhje me raportin e Avokatit të Popullit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka zoti Totozani.

Igli Totozani – Po e nis nga fundi, nga rritja e transparencës së institucionit të Avokatit të Popullit.

Me dy fjalë po ju them që institucioni auditohet nga dy drejtime. Pra, qoftë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, qoftë nga agjenci të cilat përzgjidhen me tender në bashkëpunim me partnerët danezë. Avokati i Popullit në një farë mënyrë donacion të drejtpërdrejtë ka vetëm nga Mbretëria e Danimarkës, nga Ministria e Jashtme. Ju e dini që është një ndihmë që vazhdon të jetë prej shumë vitesh dhe që do të vazhdojë dhe më pas mbarimit të mandatit tim. Çdo vit të gjitha investimet, të gjitha aktivitetet që kryhen nga Avokati i Popullit auditohen nga një agjenci e pavarur, e cila zgjidhet me tender. Pra, nuk është një e vendosur njëherë e përgjithmonë, por janë agjencitë e ndryshme që e monitorojnë.

Gjithashtu, kemi sjellë informacione të vazhdueshme. Gjeneri dhe në raport informacion për këtë, por dhe në Komisionin e Ekonomisë. Ne ndjekim të gjitha ligjet e shtetit shqiptar, linjën e buxhetit, të gjitha detyrimet që na kërkon legjislacioni shqiptar për të informuar strukturat e ndryshme mbi të gjitha donacionet që arrijnë pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Flas vetëm për projektin danez tani, sepse mund të quhen donacione të tjera, për shembull ai nëpërmjet programit Tajeks të BE-së, nëpërmjet të cilit janë dërguar për vizita studimore një pjesë e mirë e stafit të Avokatit të Popullit pranë ombucmanëve të ndryshëm. Dhe

në këtë rast janë që të gjitha transparente, pra nuk realizohen shpenzimet nga Institucioni i Avokatit të Popullit, por nga partnerët tanë.

Megjithatë, në qoftë se komisioni dëshiron që t'i ketë dhe raportet e auditimit që bëjnë agjencitë shqiptare apo të huaja, në kuadrin e projektit danez, ne jemi të gatshëm që t'ju sjellim, por ato janë publike, nuk janë dokumentacion që mbahet nga Avokati i Popullit. Janë në faqet e internetit.

Së dyti, pyetja më e bukur që keni bërë është nëse zgjidhen problemet apo jo? Në qoftë se doni përgjigje të sinqertë, mund t'ju them dhe unë sinqerisht. Kemi dy kategori çështjesh. Çështje me natyrë individuale dhe çështje me natyrë kolektive, ku një shqetësim i caktuar pret një gamë të gjerë qytetarësh. Jemi shumë të suksesshëm në lidhje me çështjet individuale. Pra, me ata individë të cilët kanë një problem të caktuar me administratën publike arrihet të gjendet gjuha. Roli ynë si ndërmjetmes në bashkëbisedimin me administratën publike është efikas në këtë drejtim. I gjithë problemi ngel, të paktën sa kam unë 3 vjet Avokati i Popullit, ngel kur trajtojmë me rekomandime fenomene të cilat prekin një numër të madh qytetarësh shqiptarë.

Nëse dëshironi mund t'ju jap shembuj, siç është rasti i ndihmës ekonomike ku realisht kemi konstatuar që ka një problematikë të madhe. Shumë familje janë hequr nga skema e ndihmës ekonomike dhe shpeshherë jo vetëm për paqartësi të sistemit të pikëzimit për të cilin kemi bërë rekomandim, na është pranuar si rekomandim, por nuk dimë që të jetë bërë ky ndryshimin dhe vazhdojnë akoma dhe sot të ketë familje të cilat nuk e meritojnë që të përjashtohet. Natyrisht ne jemi pro largimit të abuzuesve, por që duhet një kujdes më i madh. Është ndërtuar një sistem pilot Durrës-Tiranë-Elbasan, i cili vendimmarrësin dhe nevojtarin i ka shumë larg njëri-tjetrit, ndërkohë që nuk duhet të ishte kështu, minimumi duhet të ishin bërë kontrole të caktuara dhe minimumi duhet të ishte e qartë dhe skema e dhënies së kësaj.

Mund t'ju them dhe raste të tjera si për shembull rastet e energjisë elektrike, apo largimin nga puna që prekin një numër të caktuar njerëzish. Në të tilla raste nuk marrim përgjigje fare, ose marrim përgjigje evazive në të ardhmen etj. Rekomandim për shembull për rastin e zbatimit të ligjit për ngritjen e këshillit koordinues në luftën kundër gjakmarrjes. Kemi 3 vjet, të paktën sa jam unë, por dhe më përpara që kërkojnë me ngulm nga qeveritë shqiptare që ta zbatojnë këtë ligj. Pra, të ngrenë një grup pune dhe t'i miratojnë ato 3 vendime të Këshillit të Ministrave që duhen miratuar. Gjithashtu, edhe Presidenti i Republikës të mbledhë përfundimisht këshillin koordinues. A do ta zgjidhë kjo problemin e gjakmarrjes? Natyrisht që

nuk e zgjidh, por që ky ligj që në momentin që u konceptua, pra që në maj të vitit 2005 e deri më sot nuk është zbatuar asnjëherë, është një problem i madh që ne po mundohemi me rekomandime të vazhdueshme për t'i nxitur këto institucione ta bëjnë këtë gjë, por ende nuk e bëjnë. Pra, kur janë raste individuale është e thjeshtë, është më kollaj të bashkëpunohet. Kur janë raste të cilat prekin një gamë të gjerë qytetarësh është e vështirë. Normalisht numri më i madh i rekomandimeve pa përgjigje që marrim ne janë ato rekomandime që mund të jenë ose legislative, ose rekomandime që prekin një numër të gjerë ose një fashë të gjerë të qytetarëve.

Për sa u përket ankesave për gjyqësorin janë rreth 280 ankesa ndaj gjyqësorit. Natyrisht ankesat janë të shumta dhe mund t'jua përmend. Janë zvarritje të pajustificuara të gjykimit, të hetimit të çështjeve civile dhe penale. Zvarritje të cilat bien në një farë mënyre në kurriz të qytetarit. Gjithashtu, kemi probleme që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve gjyqësore, vazhdojnë vendime gjyqësore të mos zbatohen.

Një tjetër problem i madh është që shpeshherë qytetarët vijnë me ankesa për korrupsion. Pra, vijnë me ankesa për mosekzistencën e mundësive për t'u paraqitur në gjyq, apo ankesa të tjera të cilat kanë të bëjnë me një proces gjyqësor ku ne nuk hyjmë dot. Në të tilla raste ne i kemi kërkuar në bazë dhe të marrëveshjeve që kemi inspektorateve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së që t'i trajtojnë me shumë vëmendje të tilla ankesa, sidomos në ato raste kur bëhet fjalë për korrupsion në gjyqësor. Duhet thënë që me prokurorinë marrëdhënia është më ndryshe, deri diku ka një marrëdhënie më pozitive. Natyrisht kemi pasur dhe nga prokuroria raste mospërgjigjeje. Në dijeninë time të paktën është një rast që nuk i është përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit, por në përgjithësi dhe aty marrëdhëniet themi midis institucioneve janë të mira, por ka probleme dhe aty ka. Ka probleme të vendimmarrjeve që ndërmarrin prokurorë të ndryshëm gjatë proceseve hetimore, por që nuk njoftojnë palët. Pra, palët në një farë mënyre ngelin në terr. Ka vendimmarrje të cilat në disa raste pushohen çështje, për të cilat ne nuk kemi qenë dakord dhe kemi kërkuar që të rihapet hetimi i tyre.

Në këto kushte jemi. Ndarja e re administrative është shumë e rëndësishme. Me KLD-në thamë që këto problematika kemi. Nuk kemi marrë përgjigje për të gjitha rastet që kemi dërguar. Pra, kemi dërguar raste ku qytetarët ankohen, sikurse e thashë, për zvarritje për sjellje të padenjë të gjyqtarëve gjatë proceseve gjyqësore. Unë dua të them që do të duhet një bashkëpunim më i mirë. Për sa i përket ndarjes së re administrative, është një çështje, e cila është nën vështrimin tonë dhe sikurse e thatë dhe ju, kemi dhe kontribuar dhe ne, si dhe është ndjekur

vazhdimisht përgjatë gjithë kohës së reformës. Dhe përzgjedhja vetë e zyrave rajonale është vendosur në qarqe të tilla, të cilat do t'i mbijetojnë reformës administrative.

Natyrisht kemi një shqetësim, sepse bashkë me shoqërinë kemi monitoruar rreth 402 punonjës të administratës lokale dhe do të dëshironim në kuadër të kësaj reforme që ky trajnim i bërë me fondet e Mbretërisë së Danimarkës të mundet të qëndronte efektiv, pra të gjente mundësi që këta funksionarë publikë të trajnuar për të drejtat e njeriut të vazhdojnë të punojnë dhe sipas ndarjes së re administrative. Natyrisht që do të ketë shumë punë me daljen e akteve të tjera nënligjore, në zbatim të kësaj reforme, por që Avokati i Popullit ka thënë se në çdo reformë që zhvillohet, zoti Xhafaj ka qenë prezent gjatë reformës në drejtësi, ne do të jemi vazhdimisht prezent me kontributin tonë. Kemi ngritur në çdo rast reforme grupe pune brenda institucionit të Avokatit të Popullit. Sot funksionon një grup pune i mirorganizuar, i drejtuar nga komisionarët, por dhe me pjesëmarrësit e ekspertëve më të vjetër për të ndjekur të gjitha temat e reformës në drejtësi dhe për të përgatitur një mendim të plotë dhe të rëndësishëm, sugjerues, rekomandues, për reformën në drejtësi, në mënyrë që ajo të jetë sa më e përshtatshme e publikut.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj se mbaruam me pyetjet. Ka diskutime që lidhen me rezolutën besoj, qëndrimi që duhet mbajtur.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – E vlerësoj raportin e Avokatit të Popullit, një raport për mua me eksperiencë, një raport serioz me problematika nga më të ndryshmet, me arritje konkrete, me kërkesa gjithmonë në rritje. Natyrisht dhe me rekomandimet për të cilat bëra dhe pyetjet. Por nuk do të lë pa përmendur këtu edhe sukseset që ka arritur ky institucion dhe Avokati i Popullit, jo thjesht si individ, që është avokat i popullit, sepse pjesa individuale është e tij, por natyrisht është vlerësim maksimal edhe për parlamentin, edhe për shtetin shqiptar, të marrjes së statusit në Kombet e Bashkuara. Pra, të kesh të drejtën e një vendimmarrjeje, të bëhesh presidenti i obdusmanëve në rajonin e Mesdheut apo dhe raste të tjera, këto tregojnë dhe një herë vlerësimin që kanë të gjitha institucionet ndërkombëtare për institucionin tonë dhe kur e kanë për Avokatin e Popullit do të thotë që në fund të fundit vlerësohet dhe parlamenti shqiptar dhe shteti shqiptar. Ky është vlerësim dhe yni, nuk është vetëm vlerësim personal juaji. Më pëlqen që i keni

marrë të gjitha këto vlerësime dhe më pëlqen pikërisht ky raport që thashë. Këtë radhë është le të themi për shkak të eksperiencës edhe më serioze dhe më e saktë.

Pyetjet që adresova në fund të fundit kishin të bënin me kthjelltësinë e atyre që unë lexova dhe pashë nga raporti. Ishte një raport, i cili natyrisht mund të bëhet dhe me pak faqe, por problematika aty është. Janë disa problematika, të cilat duhet të zgjidhen. Unë mendoj që ato çështje të cilat, zoti kryetar, trajtova në pyetjet e mia desha të qëndronim fort në rekomandimet e Avokatit të Popullit për përmirësimin e punës për vitin e ardhshëm në këtë rezolucion që do të bëjmë. Disa nga pikat këtu mund t'i shikoj të tepërta, ose janë jo shumë korrekte, aq më tepër që duhet të kemi vlerësimin e punës dhe njëkohësisht për të dhënë atë që ishte pyetja e fundit dhe pyetja më serioze, pyetja që ka të bëjë me rekomandimet dhe me dëshirën që këto rekomandime vërtet të jenë efektive nga të gjitha institucionet, por dhe ne si parlament duhet të kërkojmë më shumë dhe duhet ta ndihmojmë më shumë me Avokatin e Popullit, që rekomandimet të jenë vërtet në ndihmë jo të individëve, siç tha avokati.

Unë e kuptoj këto janë çështje individuale dhe kolektive. Me ato individuale ju jeni më i kënaqur, sepse duke shkuar te një ministri apo te institucione të tjera mund të zgjidhin ndonjë gjë. Problemi më i madh dhe më kryesor për Avokatin e Popullit, por dhe për ne parlamentarët janë problemet kolektive. Në problemet kolektive më mirë të mos zgjidhni 5 probleme individuale dhe të zgjidhim 2-3 probleme kolektive, sepse atje ka të bëjë me një gamë të gjerë njerëzish, siç thatë ju qoftë të ndihmës ekonomike, apo qoftë dhe problematika të tjera. Mendoj se çështjet kolektive kanë më shumë vlerë dhe kanë nevojë vërtet për Avokatin e Popullit sa ç'mund të kenë çështjet individuale që individë të caktuar mund të gjejnë mënyra dhe forma të tjera për ta zgjidhur një problem të caktuar edhe pa Avokatin e Popullit. Ndërsa ato kolektive natyrisht atje duhet ngritur zëri më fort, rekomandimi më i fuqishëm, pse jo në krah tuaj që jemi dhe ne kur vjen puna, të paktën Komisioni i Ligjeve, komisioni që mbulon Avokatin e Popullit, kur ka probleme të tilla të cilat ju kërkon për të sensibilizuar më shumë opinionin dhe për të sensibilizuar institucione të caktuara të cilat duhet të kthejnë përgjigje dhe të dyja t'u japin drejtim problemeve që kanë të bëjnë me pjesën kolektive.

Këto kisha pak a shumë të cilat duke i përqendruar në 5-6 pika të rekomandimeve që janë këtu. Më vonë në qoftë se do ta kalojmë këtë mund të bëj dhe vërejtje konkrete për pikat e rekomandimit. Do të isha plotësisht dakord që ta kalojmë. Dua të falënderoj të gjithë stafin e

Avokatit të Popullit për këtë paraqitje që bëri dhe për përgjigjet që më dha, pavarësisht se prisja më shumë sinjeritet nga përgjigjet e tij. Por mbase kaq është forca e tij qoftë jona!

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Sapo the këtë zoti Fino, pashë disa nga këta gazetarët që menduan se doli lajmi për nesër, se këta nuk kanë lajm tjetër. Ngritën kokën të gjithë.

Igli Totozani - Unë jam gjirokastrit, zoti Xhafaj. Si gjirokastrit jap atë pjesë sinjeriteti që meriton një gjirokastrit.

Fatmir Xhafaj - Fjalën e ka zoti Majko.

Pandeli Majko – Edhe unë u bashkohem kolegëve parafolës, relatorit, lidhur me raportin e Avokatit të Popullit. Mendoj se është një raportim shumë serioz nga një institucion i cili ka qenë vibrant gjatë gjithë kësaj periudhe. Vetëm se unë do ta vazhdoja deri diku aty ku e la zoti Fino, që kemi të bëjmë me një institucion, i cili është kthyer më shumë në raportues sesa në një mekanizëm i cili mund t'i gjejë një zgjidhje atij që troket në derë. Po e nis nga ajo që ju keni informuar te marrëdhëniet që keni pasur me sistemin e drejtësisë ku keni nënvizuar faktin që institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 304 ankesa të adresuara nga qytetarët për veprime të padrejta, ose mosveprime të kryera nga organi i akuzës dhe veprime të kryera nga gjykata. Më pas nënvizoni që në datën 20.01.2015 i jeni drejtuar prokurorit të Përgjithshëm me rekomandimin për përmirësimin e punës me qëllim zbatimin nga prokuroria të dispozitave procedurale, për dhënien e kopjeve të akteve, shqyrtimit, vlerësimit të kërkesave, apo memorieve me shkrim, si dhe njoftimin e menjëhershëm të vendimeve përfundimtare të palëve në procesin penal. Titulli në fakt qenka goxha i gjatë, por ajo që më tërheq është se dhe sot që flasim ky rekomandim është pa përgjigje. Unë mendoj se kjo flet shumë për marrëdhëniet që ka institucioni juaj atje ku përplasen nervat, shqetësimet, problemet e qytetarëve.

Për sistemin e burgjeve sinjerisht mendoja se do të flisnit pak më gjatë, por mbasi i keni të shkruara në raport, unë nuk e kam lexuar të gjithë raportin, kam lexuar vlerësimin që ka bërë shërbimi i monitorimit të institucioneve të pavarura nga Kuvendi i Shqipërisë, ku është një përmbledhje substanciale. Kështu që duke vënë në pah dhe fjalët e mira që thanë të gjithë kolegët e mi do duke hequr dhe pjesën e çështjes së prokurorisë, apo marrëdhëniet me sistemin e drejtësisë, raportimit tuaj, zoti Avokat i Popullit i mungojnë emrat. Ju thoni që ka kaq ankesa për një institucion apo për një tjetër. Në çdo rast ankesat apo problematikat kanë emra. I vetmi emër

që kuptoj unë nga kjo që keni shkruar ju është prokurori i Përgjithshëm, që nuk i është përgjigjur një kërkesë të caktuar në një moment të caktuar. Kjo është shumë e qartë. Por ka dhe institucione të tjera që në marrëdhënie me ju kanë pasur probleme të natyrave të ndryshme. Ndoshta ju jeni institucioni që nuk ju takojnë këto fjalë. E thashë dhe në fillim fare, i dukshëm, publik, vibrant, ndonjëherë edhe me pakënaqësi nga ana jonë, nëse mund të flasim kështu për arsye të natyrave të ndryshme, për çështjet që keni trajtuar në publik. Por dëshiroj të nënvizoj faktin se këto raportime nuk mund të jenë në pamje si seminari Shqipëria çka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet! Ju jeni Avokat i Popullit, ju trokisni, ju trokasni. Duhet një sistem i cili raportimi të ketë brenda emrat e personave përgjegjës, të cilët ose shkelin ligjin, ose nuk ju përgjigjen, ose në marrëdhënie me qytetarin kanë këtë që ju e trajtoni si fenomen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Në vijim dhe të përgjigjeve të marra nga pyetjet, por dhe të leximit të kujdesshëm që i kanë bërë raportit tuaj, dhe raporti që kanë përgatitur shërbimet e monitorimit të institucioneve të pavarura të punëdhënësit të Shqipërisë do të doja t'ju falënderoja ju dhe komisionerët, por njëkohësisht nëpërmjet jush dhe komisionerëve dhe stafin e Avokatit të Popullit për gjithë punën që ka bërë në vitin 2014.

Nga ana tjetër rezervoj të drejtën të theksoj dhe një herë se ndryshimet që ne bëmë në ligjin e Avokatit të Popullit, të cilat mund të kenë qenë të debatueshme, nuk e paskan cenuar pavarësinë e këtij institucioni. Përkundrazi, institucioni është rivlerësuar me nivelin A. Dhe kjo mua më bën të ndihem mirë, për shkak sepse mendojmë që me ndryshimet që ne i bëmë ligjit e kemi forcuar këtë institucion, e kemi ruajtur pavarësinë e këtij institucioni dhe do të keni të gjithë mbështetjen tonë që të jeni një institucion i pavarur profesional dhe të rrisni sa më shumë besimin e publikut, jo vetëm në trajtimin e çështjeve ose ankesave individuale, por me zgjidhjen e problemeve që janë parimore.

Unë kam edhe një çështje apo shqetësim të dytë, që ju e thatë disa herë dhe m'u duk më se i drejtë. Edhe unë, edhe zoti Fino jua bëmë të njëjtën pyetje në dy forma të ndryshme: zbatimi i rekomandimeve. Do të kisha një sugjerim dhe do të kërkoja që kjo të pasqyrohej edhe në

rezolutë, që Kuvendi i Shqipërisë të informohej lidhur me rekomandimet, për të cilat kërkohen ndryshime ligjore.

Pa dyshim që ju ia adresoni rekomandimin institucionit përkatës, institucionit të linjës, qeverisë, Ministrisë së Drejtësisë, por nga ana tjetër, si anëtarë të Parlamentit, ne nuk e kemi për detyrë të bëjmë vetëm ligje, por ne e kemi për misionë dhe të monitorojmë qeverinë dhe zbatimin e ligjeve. Në këtë kuadër ne mund të përdorim shumë mirë edhe mundësinë që na jep ligji për të bërë nisma ligjore. Kur ne shikojmë se një rekomandim përmban një propozim për një ndryshim të ligjit, sidomos në ligjet e thjeshta – nuk flas për ndryshimet që prekin kodet, që kanë një votim të cilësuar dhe që kërkohet një proces shumë i kujdesshëm, më i harmonizuar – kjo do të qe mirë të bëhej edhe në Kuvendin e Shqipërisë.

Por, deri më sot, personalisht, unë nuk kam pasur mundësi të marr këto rekomandime të adresuara nga ana juaj. Unë i lexoj të gjitha, sepse jam vizitore e rregullt e faqes suaj zyrtare, por do të ishte mirë që të gjithë kolegët e Kuvendit t'i kishin – sidomos komisioni ynë dhe Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut – t'i kishin këto rekomandime.

Gjithashtu, zoti Avokat, do të doja që ju të ishit më të vendosur në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet. Ju keni bërë rekomandime, rekomandimet janë shumë të mira, por shumë pak njihen e mbulohen edhe nga media. Sepse, po të lexoni rekomandimet, ka probleme me të vërtetë shumë të mira. Jo vetëm media, por edhe një pjesë e mirë e deputetëve nuk i njohin, çka do të thotë se ju, jo vetëm duhet të bëni monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, por duhet të bëni më shumë sensibilitet të atyre institucioneve dhe organeve që kanë për detyrë t'i marrin këto rekomandime, t'i monitorojnë dhe të fillojnë zbatimin e tyre, me qëllim që të mos mbetemi në atë fazë, që thuhet: rekomandim i pranuar, ose i zbatuar.

Kur e them këtë, rimarr përsëri shqetësimin që ngrita vetë, zoti Fino dhe zoti Majko, që duhet të shkojmë drejt zgjidhjes së problemeve që prekin një numër të konsiderueshëm të popullsisë, dhe konkretisht të grupeve që nuk kanë zë, ose nuk kanë mundësi të përfaqësohen sa dhe si duhet në Kuvend, në institucionet e ekzekutivit.

Dhe, e fundit fare, lidhur me reformën e re territoriale administrative dhe me shtatë zyrat që kanë funksionuar dhe që ne i ligjëruam me ndryshimet që bëmë në ligj.

Pajtohem me shqetësimin tuaj se burimet njerëzore duhen ruajtur fort, sepse janë asetë, për të cilat ju keni bërë trajnimin dhe kualifikimin, por mendoj se brenda organizimit që ju keni, të tre seksioneve, që tashmë u bënë pesë, ndoshta ka vend për të riparë përshkrimet e punës dhe

fushën e kompetencave të secilit komisioner, me qëllim që ju të shmangni mbivendosjet që mund të keni, për të përdorur më mirë burimet njerëzore që keni në zyrë dhe për të lëvizur edhe në territorin e Shqipërisë.

Unë pajtohem me shqetësimin që ju ngritët, që njerëzit besojnë më shumë te figura e Avokatit të Popullit në Tiranë dhe te komisionarët. Është normale, por, që qytetarët të mos bëjnë këtë lloj shpenzimi e të vijnë nga rrethet drejt Tiranës – sepse është kosto, kohë, energji, nerva e të tjera – i duhet dhënë mundësi nivelit vendor të zgjidhë problemet e tyre, aty ku janë vetë ata që i shkelin ligjet. Më mirë është të bëni një riorganizim të kompetencave të pesë komisionarëve të pesë seksioneve që ju keni, ose të krijoni ato nënseksione, për të cilat ne jua dhamë mundësinë me ligj, dhe ta nxirrni stafin të punojë me tepër jashtë zyrës. Pa dyshim, këtu do të keni nevojë edhe për ndihmën që do të japë Kuvendi i Shqipërisë në një buxhet më të mirë për inspektimet në terren.

Unë këto kisha. Ju uroj suksese juve, tre komisionarëve, njëkohësisht Mekanizmit të Parandalimit të Torturës, por edhe të gjithë stafit tuaj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se, me sa shoh, nuk ka...

Zoti Totozani, keni ndonjë koment? Po.

Igli Totozani – Edhe unë do t'ju falënderoja për komentet tuaja. Duke filluar nga rekomandimet legislative, për t'ia dërguar një kopje Komisionit të Ligjeve; mund të jetë një eksperiencë shumë e mirë, përderisa vetë ju, në qoftë se do të gjykoni se rekomandimet janë pozitive – janë njëzet e shtatë të tilla për këtë vit, për vitin 2014 – dhe pse jo, ndoshta do të ishte më e thjeshtë, sepse, kuptohet, për burokraci të ndryshme ministritë edhe i vonojnë përgjigjet ose nuk i marrin parasysh fare.

Gjithashtu, do të kaloja tek ajo çka thatë në lidhje me aktivizimin e zyrave. Ne kemi një problem për të cilin ju kemi shkruar; pra Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar dy komisionarë të rinj për Avokatin e Popullit, por nuk i mbulojmë dot nga pikëpamja financiare dhe, praktikisht, ata dy komisionarë kanë ngelur ende në letër, me gjithë përpjekjet ona me Ministrinë e Financave për të siguruar buxhet për ata komisionarë.

Së treti, stafi i Avokatit të Popullit është vazhdimisht në terren, jo vetëm në të quajturat ditë të hapura, por sidomos në aspektin proaktiv të punës së tij. Do të thotë se ndjekjet që ne

bëjmë, rastet që marrim ne me iniciativën tonë, që janë rritur këtë vit, kanë shkuar në njëqind e nëntëdhjetë e ca, në mos gabohem, njëqind e nëntëdhjetë e dy, dhe janë që të gjitha takime në terren. Pra, në njëfarë mënyre, ka ditë që institucioni është i gjithi në terren, aq më tepër nga larmia e problematikave që ekzistojnë.

Do të doja t'i jepja përgjigje edhe zotit Majko mbi shqetësimin që ka: a ka emra, apo jo? Po, raporti vjetor i Avokatit të Popullit ka emra. Raporti i Avokatit të Popullit ka emra të disa institucioneve, të cilat po shkelin ligjin në këtë moment, por jemi në proces hetimor. Ekspertët tanë po ndjekin me shumë vëmendje disa aktivitete të INUK dhe të ndonjë rasti tjetër. Besoj se shumë shpejt ju do të shikoni se edhe në raportin që kemi paraqitur, porë dhe në aktivitetin e mëposhëm të Avokatit të Popullit do të konstatojmë që do të ketë emra.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit!

Besoj se u bëmë e qartë edhe nga kolegët se cili është qëndrimi që kemi edhe në vlerësim të punës së Avokatit të Popullit dhe të ekipit të drejtuar prej tij, edhe lidhur me rekomandimet e pritshme për vitin 2015. Natyrisht, çmuj se është e nevojshme që në lidhje me këto rekomandime, Drejtoria e Monitorimit të reflektojë edhe sugjerimet, vlerësimet pozitive apo propozimet konkrete që u bënë, për t'u pasur në vëmendje gjatë vitit 2015. Këtu, unë kisha diçka që mendoj se është e rëndësishme: që për vitin 2015, në rekomandimet tona duhet të sugjerojmë që të fokusohet më mirë roli dhe puna e Avokatit të Popullit dhe e stafit të tij, lidhur me raportin që kanë sot qytetarët me drejtësinë, me shërbimin që ata marrin nga drejtësia.

Nëse do të shikonim sot ndjeshmërinë që kanë qytetarët, edhe sipas sondazheve më të fundit që janë bërë – ishte interesant ky sondazhi i fundit i (...) – i cili tregonte shqetësimin, pritshmërinë e madhe që kanë qytetarët te drejtësia, tek organet e zbatimit të ligjit, në mënyrë të veçantë te gjykatat dhe prokuroria.

Kam pritur para disa ditësh një zotëri – bashkë me zonjën Hysi – i cili solli një dosje lidhur me një sjellje arrogante të njërit prej drejtuesve të gjykatave. Por nuk më shqetëson sjellja e tij – sepse sjellja e tij është njëra anë – sa fakti që ai sorollatet dhe nuk merr dot një përgjigje për atë çfarë ka shkruar; ai sorollatet zyrove të shtetit, sorollatet zyrove të drejtësisë, deri në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, dhe nuk e pret kush, rri prapa derës; ajo që më shqetëson është se diçka nuk funksionon. Jo vetëm që nuk funksionon sistemi dhe cilësia në dhënien e drejtësisë, por nuk funksionon as raporti që zyrat e drejtësisë duhet të kenë me qytetarin.

Me dhjetëra qytetarë vijnë e na takojnë këtu, te dyert e Kuvendit, dhe në masën mbi 50% të tyre kanë shqetësime që lidhen me drejtësinë, duke menduar, natyrisht, që ne jemi Komision Ligjesh, dhe do të duhet të jemi më të vëmendshëm – siç edhe jemi treguar më të vëmendshëm – ndaj kësaj problematike. Në këtë kontekst, mendoj se roli i zyrës së Avokatit të Popullit, i institucionit të Avokatit të Popullit, duhet të forcohet më tej. këto çështje përbëjnë një fokus prioritar për punën e institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015. Edhe për një arsye tjetër: sepse nuk funksionojnë institucionet që do të duhej të funksiononin në kontrollin e brendshëm, në prokurori apo në gjykata.

Kam dëgjuar një intervistë të Presidentit të Republikës dhe jam skandalizuar. Në Ditën e Drejtësisë, Presidenti i Republikës flet sikur flitet për gjykatat në Danimarkë, në Suedi, në Itali, në Greqi, a ku e di unë se çfarë. Vetëm për gjykatat e Shqipërisë nuk foli, që janë të mbushura me korrupsion, që KLD-ja është kthyer në një korporatë, që në vend që të flitet për drejtësi, po flitet gjithmonë e më shumë për rryshfet dhe korrupsion.

Kjo është e rëndë. Nuk po i hyj pastaj logjikës së Presidentit, një logjikë tërësisht antikushtetuese, që Sekretari i Përgjithshëm na zëvendësoka zëvendëskryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë si funksion kushtetues. Sipas kësaj logjike, kur udhëtoka Presidenti i Republikës jashtë vendit, e zëvendësoja Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës! Jo që nuk është logjikë kushtetuese, por nuk është as logjikë institucionale. Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë do të duhej të fliste dhe duhet ta fokusojë – këshilli i vet gjithashtu – funksionin e përgjegjësinë e vet pikërisht te shërbimi ndaj qytetarëve, te raporti me qytetarët. Shqetësimi më i madh që kemi sot është mungesa e publikut te drejtësia. Në këtë kontekst mendoj se është shumë e rëndësishme që ne si Komision i Ligjeve, të jemi më të vëmendshëm në këtë çështje. Natyrisht, këtë duhet ta reflektojmë gjatë rezolutave që do të miratojmë në parlament me institucionet e drejtësisë, me institucione të tilla të rëndësishme kushtetuese, siç është institucioni i Avokatit të Popullit, i cili ka një rol të rëndësishëm e që mund të luajë një rol akoma më të rëndësishëm aktiv në këtë shqetësim të madh të qytetarëve të këtij vendi.

Edhe një herë faleminderit, zoti Avokat i Popullit! Faleminderit ekipit tuaj, që ju ka shoqëruar këtu! Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.05.2015, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

“Raporti vjetor i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2014”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduart Halimi, Arben Ristani, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Tom Doshi, Silva Caka, Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Irma Baraku – komisionere, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ardiana Hala – këshilltare, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: “Raporti vjetor i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2014”

Raporti i zonjës komisioneve është një raport i plotë, i detajuar. Kemi dhe një analizë të paraqitur nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura.

Fillimisht, le të dëgjojmë zonjën Baraku në një përmbledhje, sepse s’besoj se ka marrë përsipër të lexojë raportin, që e kemi përpara të gjithë, mbi tavolinë. Jo për shkakun e është një raport voluminoz, por më shumë për arsien se është i njohur prej nesh, përpos faktit se edhe Drejtoria e Monitorimit ka bërë këtu një përmbledhje për të gjithë deputetët. Kemi edhe rezolutën. Pastaj është edhe relatori, i cili do të japë sugjerimet e veta. kështu që, zonja Baraku, pa u përqendruar tek ato letrat – se tashti jeni me eksperiencë – një përmbledhje të shkurtër, ju lutem! Faleminderit! Fjala për ju.

Irma Baraku – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë!

Komisionari për mbrojtjen nga diskriminimi, edhe gjatë vitit 2014 është mbështetur në planin strategjik 2012–2015, në udhëzuesin për pesë prioritetet, si dhe në vlerësimet e rekomandimet e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, të shprehura në rezolutën për vlerësimin e punës së Komisionarit për vitin 2013.

Komisionari për mbrojtjen nga diskriminimi, në përmbushje të objektivave të parashikuara në gjithë aktivitetin e tij, është përqendruar kryesisht në tre drejtime, të cilat u korrespondojnë edhe kompetencave që ligji i jep këtij institucioni. Së pari, me ofrimin e një asistence të kualifikuar ndaj viktimave të diskriminimit, përmes trajnimit të aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë: trajnimin e vazhdueshëm të stafit të Komisionari për mbrojtjen nga diskriminimi, për të dhënë vendime që janë në përputhje dhe të mbështetura në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut dhe frymën e parimeve të vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

Për këtë arsye, përveç të gjitha trajnimeve të tjera që organizohen brenda Shqipërisë apo jashtë saj, besoj se një hap i rëndësishëm është përfshirja e pesë anëtarëve të stafit në programin HELP të Këshillit të Europës, për çështjet e diskriminimit, një trajnim online, që është i vazhdueshëm për trajnimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë në pesë rrethe të Shqipërisë, për trajnimin e nëpunësve të administratës vendore për trajtimin në barazi dhe pa u diskriminuar të qytetarëve, trajnimin e përfaqësuesve të dhomave të tregtisë, meqenëse një ndër

aspektet e rëndësishme është edhe trajtimi i çështjeve të diskriminimit në sektorin privat, si dhe trajnimin e organizatave të shoqërisë civile mbi identifikimin e rasteve të diskriminimit dhe rrugët që mund të ndiqen për të asistuar viktimat e sjelljes diskriminuese. Kjo, duke pasur parasysh se Komisionari nuk ka zyra rajonale, por ka vetëm një zyrë qendrore, dhe bashkëpunimi e bashkërendimi i aktivitetit me gjithë këta aktorë është domosdoshmëri.

Në kuadër të ofrimit të kësaj asistence të kualifikuar, mund të them se ne konstatojmë rritjen e numrit të ankesave pranë institucionit të Komisionarit. Gjatë këtij viti Komisionari ka trajtuar gjithsej 308 çështje, nga të cilat 290 ankesa individuale dhe 18 çështje të iniciuara nga zyra e Komisionarit. 6% e këtyre kërkesave vijnë nga organizatat e shoqërisë civile.

Mund të konstatohet e shkaku kryesor për të cilin janë paraqitur ankesat apo janë trajtuar rastet e diskriminimit, kryesisht kanë të bëjnë me racën, duke e parë në fakt, në këndvështrimin e kuptimit i jep EKRI. Njëkohësisht, ka edhe një sërë shkaqesh të tjera, siç është gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, bindjet politike, vendbanimi e të tjera si këto.

Për sa i takon shtrirjes gjeografike të çështjeve të diskriminimit q kemi trajtuar, ato vijnë nga i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, kryesisht nga ato rajone apo nga ato bashki a komuna – deri tani –në të cilat ka pasur një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse të realizuara nga Komisionari.

Në lidhje me parashikimin që bën ligji, për sa i përket fushave, mund të themi se ka ankesa në të treja fushat që parashikon ligji: ankesa në fushën e të mirave dhe shërbimeve, që përbëjnë numrin më të madh, në krahasim me dy fushat e tjera, kanë të bëjnë kryesisht me mohimin e përshtatjes së arsyeshme, vonesat në pagesat e pensioneve të invaliditetit, vonesa në marrjen e masave mujore të ndihmës ekonomike e të tjera.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit, mund të themi se është e lidhur kryesisht me sjelljet diskriminuese që shfaqen përmes transferimit apo zgjidhjeve për shkaqe abuzive të marrëdhënieve të punës. Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit, shfaqet kryesisht në formën e mohimit apo mospranimit të integritetit të fëmijëve me aftësi të kufizuara apo aftësi ndryshe, kryesisht ata me probleme të autizmit në shkollat e zakonshme, apo mospranimit të regjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom në shkollat nëntëvjeçare dhe të mesme, apo edhe për mospranimin për të zbatuar dispozita ligjore, të cilat do ta nxisin arsimimin e fëmijëve që u përkasin këtij komuniteti.

Gjatë këtij viti Komisionari është investuar për të zgjidhur edhe çështje të tjera përmes inicimit prej vetë institucionit. Kryesisht, informacioni vjen nga media ose nga përfaqësues të shoqërisë civile.

Një nga aspektet e tjera, që ka të bëjë me një asistencë të kualifikuar për viktimat e sjelljes diskriminuese, ka të bëjë edhe me dhënien e vendimeve, që në fund të fundit do të ktheheshin në vendime strategjike për mbrojtjen nga diskriminimi. Në 209 çështjet, të cilat kanë përfunduar gjatë këtij viti, mund të themi se në 32 prej tyre është konstatuar diskriminimi. Ndërkohë janë zhvilluar edhe 18 çështje në seanca dëgjimore me palët, pranë institucionit.

Kryesisht, vendimet e diskriminimit kanë të bëjnë me diskriminimin përmes përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBT, diskriminimi në formën e viktimizimit për shkak të shtatzënisë, në fushën e punësimit, arsimit dhe me ofrimin e shërbimeve.

Duke ushtruar të gjitha kompetencat që ligji i ka dhënë institucionit të Komisionarit, mund të konstatojmë lidhjen e numrit të çështjeve të trajtuara nga gjykata, vendimeve gjyqësore të dhëna për diskriminim dhe kërkesës së gjykatës për opinionin e Komisionarit, apo pjesëmarrjen e Komisionarit si palë e tretë në procesin gjyqësor.

Gjët vitit 2014 ne kemi qenë pjesë e 18 proceseve gjyqësore, dhe mund të them se në 6 prej këtyre rasteve kemi qenë si palë e paditur në lidhje me vendimet për diskriminim apo vendimet për sanksion me gjobë, në 3 raste si palë e tretë, si palë e interesuar, në 6 raste është kërkuar dhënia e mendimit me shkrim në gjykatë, ndërsa në 3 raste të tjera, Komisionari vetë ka kërkuar lëshimin e urdhrat të ekzekutimit nga gjykata, për sanksionet me gjobë.

KMD ka konstatuar se është një domosdoshmëri njohja dhe zbatimi i detyrimit ligjor nga ana e gjyqtarëve për njoftimin e institucionit të Komisionarit për çështjet me objekt diskriminimin, sepse ka ndodhur që ne të kemi filluar shqyrtimin e një rasti; pala e cila pretendonte diskriminimin nuk e ka bërë të qartë dhe nuk e ka bërë prezent për Komisionarin, që ka ngritur edhe një padi, një proces gjyqësor, dhe ndërkohë gjykata nuk e ka informuar Komisionarin që ka një padi për diskriminim.

Në hartimin e kërkesë-padive, avokatët duhet të vendosin objekt-kërkesën për konstatimin e diskriminimit, duke referuar në bazë ligjore të kërkesë padisë, ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Së treti, vërejmë që, pavarësisht se kjo bazë ligjore mund të përdoret, dhe pavarësisht se një pjesë e mirë e argumentimit dhe arsyetimit të vendimit të gjykatës i referohet ligjit “Për

mbrojtjen nga diskriminimi”, në fund gjyqtari nuk shprehet për diskriminim, por shprehet vetëm për largimin e paligjshëm nga puna.

Aspekti i dytë i veprimtarisë së Komisionerit është i lidhur me ndërgjegjësimin. Mënyrat që ne kemi përdorur për ndërgjegjësimin kanë qenë hartimi, botimi dhe shpërndarja e materialeve informuese. Gjatë këtij viti janë botuar rreth 11 tituj të ndryshëm, ku përfshihen manuale, broshura, fletëpalosje. Ndër të tjera do të përmendja, në mënyrë të veçantë, botimin e një përmbledhjeje me vendime të komisionerit, një manual për trajnimin e OJF-ve për çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe një përmbledhje të botimeve të Gjykatës së Strasburgut, të Gjykatës së Drejtësisë së BE-së dhe të disa prej institucioneve të barazisë, që bëjnë pjesë në rrjetin acquinet të organeve të barazisë në Europë.

Aktivitete të tjera kanë të bëjnë me organizimin e trajnimeve dhe të seminareve, dhënien e opinionëve në aktivitete të organizuara nga aktorë të tjerë, organizimi i ditëve të hapura, ku kanë marrë pjesë rreth 385 pjesëmarrës dhe ku janë përfshirë grupe të ndryshme vulnerabël, rritja e visibilitetit në medie, leksione të hapura me studentët e të tjera.

Së treti, është dhënia e rekomandimeve legislative. Komisioneri ka synuar në përafrimin e legjislacionit ekzistues dhe ka bërë rekomandimet për Kodin Penal, të Punës, të Familjes, të Procedurës Civile, Kodin Zgjedhor, të cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në kërkesën për të pasur një përafrim për sa u takon shkaqeve të diskriminimit për të cilat këto ligje ofrojnë mbrojtje, të ketë një përafrim për format e diskriminimit që parashikojnë këto kode dhe ligje dhe të ketë një përafrim për sa i takon shpërndarjes së bankës së provës kur trajtohen rastet e diskriminimit.

Së fundi, në fund të vitit 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pas marrjes së statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, kishte mundësinë, sepse ky ishte kriter, që të bëhej pjesë e rrjetit të institucioneve të barazisë. Staf i është përfshirë në grupet e punës që kryesisht përqendrohen në çështje të barazisë së komunikimit, hartimit të politikave, në çështjet gjyqësore strategjike e të tjera.

Për sa u takon problematikave që kanë të bëjnë me grupet kryesore vulnerabël, në kapitullin e parë kemi bërë një prezantim të situatës së diskriminimit duke u mbështetur jo vetëm në informacionin që vjen nga komisioneri, por duke pasur parasysh të gjitha opinionet, raportimet, studime të institucioneve, të OJF-ve, të organizatave ndërkombëtare, të cilat konsistojnë në problematika që kanë të bëjnë me komunitetin rom në lidhje me gratë, ndërkohë

që një situatë shqetësuese është për fëmijët e rrugës, për të cilët kërkohet një mbështetje që kërkon ndryshime edhe në legjislacion. Ideja është që për fëmijët që u përkasin familjeve që janë me ndihmë ekonomike dhe që legjislacioni i parashikon një rimbursim 100%, bëhet pikërisht pengesë fakti se në momentin kur duhet t'i blejmë mjetet shkollore dhe librat të cilat nuk kanë mundësinë t'i blejnë, t'i marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo nëpërmjet rimbursimit.

Dhënia e rekomandimeve për çështje të ndryshme ka qenë një ndër aspektet e rëndësishme të aktivitetit tonë. Kemi dhënë rekomandime, për shembull, për ndryshimin e kontratës tip mbi kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë.

Rekomandime, si çdo vit tjetër, para fillimit të vitit shkollor, janë dërguar për Ministrinë e Arsimit në lidhje me marrjen e masave që do të nxisnin barazinë në arsimim dhe këtu i referohem në mënyrë të veçantë edhe komunitetit rom dhe fëmijëve me familje të ngujuara apo fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Rekomandime të tjera kanë të bëjnë me trajtimin në institucionet e ekzekutimit të vendimit penal që kanë të bëjnë me personat që kanë probleme të caktuara të mungesës së medikamenteve mjekësore duke qenë në një gjendje shëndetësore ndryshe nga të tjerët dhe që kanë të bëjnë me zgjerimin e listës së barnave, e cila do të ndihmonte shumë persona në gjendje shëndetësore shumë të vështirë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë si relator nuk do të zgjatem, pasi kolegët i kanë konkluzionet nga Shërbimi i Monitorimit. Ajo që do të nënvizoja shkurtimisht është fakti që kemi të bëjmë me një institucion, i cili është duke u maturuar, është duke gjetur vetveten. Është një eksperiencë e re për terrenin shqiptar. Si institucion funksionon prej 5 vjetësh dhe e ka bashkëshoqëruar në thelb forcimin e kësaj agjencie shtetërore qoftë në formimin e vetes, qoftë edhe në të mësuarin e institucioneve shtetërore në raport me këtë agjenci. Kështu që unë do të thosha se fjalët e tjera do të ishin të tepërta, çdo gjë tjetër e shkruar në rezolutë lidhet me ato që konsiderohen arritje dhe ato që konsiderohen detyra dhe detyrime lidhur me të ardhmen e këtij institucioni.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

A ka pyetje?

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë kam dy pyetje që kanë të bëjnë me ankesat. Konstatojmë një rënie të ankesave për vitin 2014 në raport me vitin 2013. A keni bërë ndonjëherë analizë pse? E para.

E dyta, shoh se ka një rënie të hetimeve kryesisht nga 25 që keni pasur në vitin 2013 në 8 në vitin 2014. A mund të kemi një përgjigje pse? Ju thatë në fjalën tuaj se keni pasur një përballje të vështirë me sistemin gjyqësor, pra shpesh vendimet tuaja kanë vajtur në gjykatë dhe gjykata nuk është shprehur në lidhje me motivin e diskriminimit. Mua më shqetëson në fakt kjo dhe pajtohem me shqetësimin tuaj. Si e keni menduar marrëdhënien tuaj me Këshillin e Lartë të Drejtësisë? Në fund të fundit, është ai Këshill, i cili bën inspektimet tematike lidhur me problemet e mosdiskriminimit dhe me hetimin e këtij motivi.

Të mos harrojmë se kemi bërë ndryshime në Kodin Penal dhe të Procedurës Administrative, edhe me të vërtetë dhe unë ndiej keqardhje dhe pajtohem me ju që sistemi i drejtësisë ende nuk e ka idenë se ç'do të thotë motiv diskriminues dhe nuk e di a e njohin dhe ligjin me të cilin ju punoni.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Baraku.

Irma Baraku – Për sa i takon numrit të ankesave të hetimit kryesisht, duhet thënë se vërtetë ai ka rënë, por unë e lidh këtë me ndërgjegjësimin e individëve për të drejtuar ankesat pranë institucionit, pasi shihet që ka një rritje të dukshme të ankesave individuale. Nëse vitin e kaluar, për shembull çështje që kanë të bëjnë me integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, i kemi nisur kryesisht, sepse nuk ishte një ankesë individuale, informacionin e merrnim përmes medias dhe e inicionim ne si komisioner, tashmë kemi individë, të cilët nuk dalin në shtyp, por vijnë dhe bëjnë ankesa të drejtpërdrejta pranë komisionerit.

Së dyti, mund të themi që stafi i komisionerit që nuk ka ndryshuar në numër, tashmë merr pjesë në vazhdimësi në procese gjyqësore. Ka qenë prezent edhe në çështje që kanë të bëjnë me ankimin ndaj vendimeve të komisionerit, por edhe në çështje të cilat shkojnë direkt në gjykatë pa ardhur te komisionari dhe pastaj atje personi që ngre padinë ose vetë gjykata kërkojnë prezencën e komisionarit apo opinionin me shkrim të komisionerit.

Ndërsa për sa i takon aspektit të tretë, sipas mendimit tim, nuk mbetet vetëm te gjykata, është edhe te gjykata, është edhe tek avokati, është mënyra se si paraqitet kërkesëpadia dhe sesi trajtohet pastaj nga gjykata, por ekzistojnë të dyja faktet, pra edhe fakti ku padija vendos si bazë

ligjore ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, por nuk pretendon diskriminimin, edhe fakti që mund të pretendohet diskriminim dhe gjykata nuk shprehet fare për diskriminim, pavarësisht se në arsyetimin e saj i gjithë argumenti është i mbështetur në bazën ligjore që rregullon çështjet e diskriminimit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - A ka pyetje të tjera?

Zoti Fino.

Bashkim Fino – A e keni parë ju rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në autoritetin e institucionit që është krijuar! Në materialin e analizës thuhet që është rritur në mënyrë jo të ndjeshme numri i ankesave të publikut. Pra, me fjalë të tjera, publiku, jo politikanët, a e dinë që ekziston një institucion i tillë që i mbron nga diskriminimi dhe që mund të vijnë e të ankohen te ju si komisionere? Sepse ky është thelbi. Si e keni vlerësuar ju si komisionere rritjen e visibilitetit të institucionit tuaj në medie? Unë e kam lexuar materialin, kam parë workshopet që keni bërë, takimet, konferencat e shtypit, faqen e internetin, por mos duhet më shumë emisione televizive për edukimin dhe për të kuptuar njerëzit që ka një institucion të cilit mund t'i drejtohen me një numër telefoni e të tjera? Jam i bindur se po të bëhet një punë e tillë nga të gjitha mediet, jo se do t'u rriste punën ju, por do të ishte më mirë për njerëzit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Baraku.

Irma Baraku – Unë do të thosha që është rritur ndjeshëm njohja e institucionit nga publiku, pavarësisht shifrave, por ato shifra tregojnë se vërtet individët dukshëm po vijnë tek institucioni. Po të shohim se kush ankohet, të gjitha ankesat individuale nuk vijnë nga persona që mbajnë një post, sepse zakonisht këto persona janë te pala tjetër, janë përballë, ndërkohë që individët që ankohen janë qytetarë të thjeshtë nga i gjithë territori i Shqipërisë. Besoj se kjo na jep optimizëm për të ardhmen e institucionit.

Për sa i takon pyetjes në lidhje me kërkesat që shkojnë direkt në gjykatë, por vijnë edhe te komisioneri. Ato kur marrin një vendim nga komisioneri, shkojnë edhe në gjykatë tregon se po ndërgjegjësohen për të gjitha mundësitë që u jep ligji për t'u mbrojtur nga sjellje diskriminuese.

Për sa i takon vlerësimit të visibilitetit duhet thënë që unë jam përpjekur të paktën personalisht të kem një prezencë në medie aq sa të mos quhem e konsumuar, në kuptimin e

faktit të kompetencave që i ka dhënë këtij institucioni ligji. Po të shohim kompetencat, në fakt, jemi quasi gjykatë, dhe në këtë mënyrë jemi përpjekur që të kemi një balancim midis ndërgjegjësimit, prezencës në publik, por edhe aktiviteteve përmes këtyre konferencave dhe ajo që është më e rëndësishme asistencë ndaj viktimave.

Për sa i takon visibilitetit në medie jemi përpjekur të gjejmë ato emisione që janë më të ndjeshme dhe më të prekshme për shumicën e popullsisë. Në referencë të raporti kemi dhënë titujt e disa emisioneve që kryesisht janë të lidhur me probleme sociale dhe që shihen nga një masë e gjerë e popullsisë. Ndërkohë për sa i takon asistencës që ne u japim viktimave, unë do të sillja në vëmendje se deri tani në të gjitha vendimet që komisioneri ka dhënë qoftë për diskriminim, qoftë për gjobë dhe që kanë kaluar edhe në gjykatën e Apelit, gjykatat në përgjithësi e kanë lënë në fuqi vendimin e komisionerit. Kemi vetëm një rast që vendimi është hedhur poshtë dhe që ne e kemi ankimuar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Zonja Hysi kishte diçka për rezolutën.

Vasilika Hysi - Do të doja të falënderoja edhe relatorin, edhe stafin e shërbimit të komisionit të pavarur për raportin dhe për projektrezolutën, por, duke vlerësuar njëkohësisht edhe rëndësinë që ka komisionari për parandalimin e diskriminimit, kam një sugjerim për të shtuar në rezolutë një rekomandim konkret lidhur me forcimin e bashkëpunimit midis komisioneres dhe institucioneve të drejtësisë, konkretisht me Prokurorinë e Përgjithshme dhe me KLD-në, jo vetëm në inspektimin që do t'u bëjnë vendimeve të gjykatës, inspektimeve tematike lidhur me hetimin dhe trajtimin e motiveve diskriminuese, pavarësisht në fushën penale civile administrative të marrëdhënieve të punës, po njëkohësisht edhe në respektimin e çështjeve me motiv diskriminues. Unë, zonja komisionere, nuk pajtohem me ju në një pikë se për pjesën tjetër jam dakord, që qytetari nuk e ngre këtë motiv. Po mos harroni, standardi para provës ka lëvizur dhe, nëse një qytetar rom, egjiptian ose dikush tjetër shtetas i huaj ankohet në prokurori për një vepër penale, nuk ka nevojë prokurori të presë palën që të thotë motivin diskriminues. Do ta hetojë vetë. Unë po e zgjeroj pak. Mua nuk më pëlqeu që u morët vetëm me gjykatën. Motivet diskriminuese janë me shumicë në Europë. Raporti i fundit i Francës ju e dini se ka pasqyruar gjendjen alarmante në vitin 2014 dhe nuk bën përjashtim edhe situata në Shqipëri, por njerëzit nuk janë të sensibilizuar dhe nuk dinë si ta kërkojnë.

E dyta, kam një rekomandim që duhet shtuar në projektrezolutë. Keni bërë një punë shumë të mirë në rekomandimet për ndryshimet e ligjeve. Ky komision ka marrë në konsideratë pothuajse të gjitha rekomandimet, në të gjitha Kodet, legjislacionin, por është mirë që të gjitha këto rekomandime që ju bëji për nisma ligjore ose shqetësime që ju hasni mund t'ua adresoni në formën e një letre komisioneve të përhershme parlamentare, por edhe nënkomisioneve sipas fushës që kanë.

Rekomandimin e tretë e kam për qeverisjen vendore. Kemi bërë një reformë shumë të rëndësishme në qeverisjen vendore. Do të kemi një qeverisje të re vendore pas zgjedhjeve të 21 qershorit. Unë do të doja që në rezolutë të gjeja një pikë sesi ju do të rrisni bashkëpunimin me institucionet e dala nga zgjedhjet vendore për të rritur sensibilizimin tyre në kuadër të mosdiskriminimit të grupeve të veçanta aty ku ata operojnë, te pika 2 e rezolutës. Në pikën 10 të projektrezolutës është thënë “të rrisë shkallën e bashkëpunimit”, por do të thosha në mënyrë të veçantë me prokurorinë, me KLD-në, me organet e qeverisjes vendore.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit! A ka ndonjë nga kolegët diçka tjetër?

Atëherë Drejtoria e Shërbim të Monitorimit, stafi që është këtu të reflektojë sugjerimet që u bënë nga zonja Hysi, por edhe ato që u parashtruan në pyetjet dhe diskutimet e bëra nga zoti Majko dhe zoti Fino, në mënyrë që së bashku me rezolutën për zyrën e Avokatit të Popullit të paraqiten për t'u miratuar në komision dhe më pas në seancë plenare. E mbylлим sot këtu mbledhjen.

Nesër kemi raportin e ministrit të Drejtësisë për inspektimet në prokurori për vitin 2014 dhe projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9870, datë 04.02.2008 “Për standardizimin”, të ndryshuar”.

MBLEDHJA MBYLLET